

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM



**Raport tremujor
Gusht 2023**



Përmbajtja

I. Lëvizjet makroekonomike	5
1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar	5
1.2. Oferta vendase.....	9
1.3. Kërkesa agregate	13
<i>1.3.1 Konsumi personal.....</i>	<i>14</i>
<i>1.3.2. Konsumi publik</i>	<i>16</i>
<i>1.3.3. Konsumi i investimeve</i>	<i>16</i>
<i>1.3.4. Kërkesa neto e eksportit.....</i>	<i>17</i>
1.4. Punësimi dhe rrogat	18
1.5. Inflacioni	20
<i>1.5.1. Inflacioni aktual</i>	<i>20</i>
<i>1.5.2. Pritshmëritë inflacioniste.....</i>	<i>23</i>
1.6. Bilanci i pagesave	24
<i>1.6.1. Llogaria rrjedhëse</i>	<i>25</i>
Shtojcë: Tregtia e jashtme e mallrave dhe lëvizja e kursit efektiv nominal dhe real të këmbimit (NEDK dhe REDK)	26
<i>1.6.2. Llogaria financiare.....</i>	<i>30</i>
<i>1.6.3. Pozicioni investues ndërkombëtar dhe borxhi i jashtëm bruto.....</i>	<i>31</i>
II. Politika monetare.....	35
2.1. Likuiditeti bankar	37
III. Lëvizjet e tregjeve financiare.....	38
3.1. Tregu ndërbankar i depozitave të pasiguruara	39
3.2. Tregu i letrave shtetërore me vlerë.....	39
3.3. Bursat.....	42
IV. Agregatët monetarë dhe kreditorë.....	43
4.1. Agregatët monetarë.....	43
4.2. Aktiviteti kreditor.....	46
V. Financat publike.....	49

Hyrje

Banka Popullore vazhdoi të shtrëngonte politikën monetare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, që filloi nga fundi i vitit 2021. Kështu, norma bazë e interesit u rrit dy herë më tej, duke arritur në 0,5 p.p., me ç'rast norma e interesit arriti nivelin prej 6,0%. Në përputhje me rritjen e normës bazë të interesit, u rritën edhe normat e interesit të depozitave të disponueshme njëditore dhe shtatëditore, të cilat arritën në 3,90%, përkatësisht 3,95%. Shtrëngimi i vazhduar i politikës monetare synon stabilizimin e inflacionit dhe të pritshmërive inflacioniste të shkaktuara nga goditjet e jashtme të çmimeve. Konkretisht, gjatë tremujorit të dytë, norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohet, siç u ngadalësua edhe inflacioni bazë. Megjithatë, inflacioni mbetet i lartë dhe mbi mesataret historike, ashtu si edhe inflacioni bazë, duke sugjeruar që efektet e bartura të çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve nuk janë shterur ende plotësisht. Ky përcaktim monetar mbështetet dhe përforcohet nga disa ndryshime në instrumentin e rezervës së detyrueshme, të menduara për të rritur kursimet në denar, si dhe nga masat sistimore dhe makroprudenciale, si vendosja e një shtrese mbrojtëse kundërciklike të kapitalit dhe e pragjeve për monitorimin e cilësisë së kërkesës për kredi, i cili forcon më tej rezistencën e sistemit bankar. Për të stabilizuar inflacionin dhe pritshmëritë inflacioniste në një bazë më të qëndrueshme, bankat qendrore kryesore vazhdojnë të shtrëngojnë politikën monetare, por me një forcë më mesatare. Pra, duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit stabil të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare vendore pasqyrojnë edhe ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane.

Ekonomia globale mbetet me perspektiva të pasigurta, duke pasur parasysh vazhdimin e luftës në Ukrainë. Çmimet më të ulëta të energjisë dhe të produkteve të tjera parësore, në kushtet kur efektet e shpenzimeve të larta të energjisë dhe pengesat në furnizim po zhduken ngadalë, ndikuan në ngadalësimin e inflacionit të përgjithshëm dhe si rrjedhim, në uljen e mëtejshme të pritshmërive inflacioniste. Por, nivelet më të larta të çmimeve në vazhdim, së bashku me kushtet shtrënguese financiare dhe kreditore globale, që pritet të jenë të pranishme për një periudhë të gjatë kohore, krijojnë rreziqe negative për aktivitetin global, pavarësisht sinjaleve pozitive nga çelja e plotë e ekonomisë kineze më herët se sa pritej.

Treguesit më të fundit të ekonomiasë vendase sugjerojnë një pasqyrë makroekonomike që në përgjithësi korrespondon me vërtetimet e muajit prill, ndonëse në segmente të caktuara vërehen shmangie të caktuara. Të dhënat e publikuara të PBB-së tregojnë për një rritje reale vjetore prej 2,1% në tremujorin e parë të vitit 2023, që paraqet një përshejtim të rritjes pak më të fortë se sa ishte parashikuar për këtë periudhë, në kuadër të ciklit të projeksioneve të prillit. E analizuar sipas komponentëve, rritja në tremujorin e parë lidhet tërësisht me kontributin pozitiv të eksporteve neto, gjatë rritjes solide të eksporteve dhe rënies së importeve. Kërkesa vendore ka një kontribut negativ, i cili ndodh më së shumti për shkak të rënies së lartë të investimeve bruto, që nga ana tjetër është një pasqyrim i inventarëve më të ulët gjatë bazës së lartë krahasuese - kryesisht për shkak të efekteve të pafavorshme të luftës në Ukrainë në vitin e kaluar, para së gjithash në sektori i energjisë. Rënie shënoi edhe konsumi publik, për dallim nga konsumi i amvisërive, i cili shënoi rritje, ndonëse me ritme më të ngadalta. **Të dhënat e disponueshme me frekuencë të lartë për aktivitetin ekonomik të tremujorit të dytë të vitit 2023 tregojnë për vazhdimin e rritjes së aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit, por me dinamikë më mesatare.** Gjatë vitit 2023 pritet një rritje ekonomike prej 2,1% dhe më pas përshejtim i saj në 3,6% dhe 4% në vitin 2024, përkatësisht 2025. Rreziqet për perspektivat ekonomike vazhdojnë të lindin nga zhvillimi i luftës në Ukrainë, tensionet gjeopolitike në korniza globale, forca e shtrëngimit të kushteve financiare, si dhe nga trazirat e mundshme të mëtejshme në sektorin financiar.

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, norma vjetore e inflacionit u ngadalësua më tej në 11.2%, në përputhje me projeksionin e prillit. Rritje e ngadaltë e çmimeve vendore vërehet në të tri kategoritë kryesore – ushqime, energji dhe inflacion bazë. Mirëpo, pasiguria e lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve primare dhe ndikimi i tyre në çmimet vendore vazhdon të jetë e theksuar, në kushtet e efekteve të pasigurta ekonomike nga lufta në Ukrainë. Sipas vlerësimeve të prillit, inflacioni pritet të jetë në intervalin prej 8 deri 9% për vitin 2023 dhe stabilizimi i tij nën 3% në vitin 2024.

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, aktiviteti kreditor i sektorit bankar shënoi rritje në bazë tremujore, pas stagnimit në tremujorin pararendës, me rritjen e kredisë në të dy sektorët. Në bazë vjetore, në përputhje me shtrëngimin gradual të politikës monetare, **shkalla e rritjes së totalit të kredive vazhdon të ngadalësohet mesatarisht dhe në tremujorin e dytë të vitit 2023 është 6,5%**, që është pak më lart se projeksioni i prillit. Ngadalësimi pritet të vazhdojë deri në fund të vitit, me ç'rast do të ulte rritjen e kredive në 5,7% deri në fund të vitit, në kushte më të shtrënguara financiare dhe kreditore, në përputhje me rritjen e normës referencë të interesit dhe masat makroprudenciale të zbatuara në periudhën e kaluar. Nga pikëpamja e burimeve të financimit, në tremujorin e dytë u vu re një rritje tremujore edhe në bazën e depozitave, pas rënies së zakonshme sezonale në tremujorin e parë, që kushtëzon **përshejtimin e mëtejshëm të rritjes vjetore të depozitave prej 11,6%, që është mbi pritshmëritë për fundin e tremujorit të dytë, sipas projeksionit të prillit**. Në të njëjtën kohë, vazhdojnë lëvizjet e favorshme në aspekt të strukturës valutore dhe të maturimit të kursimeve (rritje e depozitave afatgjata dhe në denar), duke pasqyruar efektet e masave të ndërmarra nga Banka Popullore dhe pritshmëritë e stabilizuara të subjekteve ekonomike.

Të dhënat më të fundit të disponueshme për bilancin e pagesave tregojnë për realizime më të mira në llogarinë aktuale, ndërsa në të njëjtën kohë flukse hyrëse financiare neto më të ulëta se sa pritej. Në tremujorin e parë të vitit 2023, llogaria aktuale e bilancit të pagesave shënoi suficit prej 0,9% të PBB-së, që përbën një përmirësim të ndjeshëm ndaj deficitit të lartë në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Lëvizjet e favorshme në transaksionet aktuale janë rezultat i realizimeve pozitive thuajse në të gjitha kategoritë, por faktori dominues është ulja e ndjeshme e deficitit në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja, kryesisht për shkak të uljes së importeve. Konkretisht, ngushtimi i deficitit tregtar, në pjesën më të madhe vjen nga përmirësimi i bilancit energjetik, si pasojë e rritjes së prodhimit vendas dhe konsumit më të ulët të energjisë, por përmirësim, ndonëse më mesatar, shënoi edhe bilanci tregtar joenergjetik. Në të njëjtin drejtim ka vepruar edhe suficiti më i lartë në tepricat e të ardhurave dytësore dhe të shërbimeve. Llogaria financiare në tremujorin e parë të vitit regjistroi flukse hyrëse mbi bazën neto prej 1% të PBB-së, kryesisht si rezultat i hyrjeve neto të realizuara në investimet e portofolit (huamarrje e shtetit në tregun ndërkombëtar), dhe në një masë më të vogël në investimet e drejtpërdrejta. Të dhënat për rezervat valutore bruto për tremujorin e dytë tregojnë realizime më të mira se sa pritej sipas parashikimeve të muajit prill, me ç'rast vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt.


Në përgjithësi, treguesit më të fundit makroekonomikë sugjerojnë se realizimet në segmentet kryesore janë përgjithësisht në përputhje me pritshmëritë, por rreziqet për inflacionin vazhdojnë të mbijetojnë. Dinamika vjetore e rritjes së çmimeve vendase ka vazhduar të ngadalësohet në përputhje me pritshmëritë, në kushtet e trysnive të reduktuara nga çmimet e importit, por niveli i inflacionit total dhe atij bazë vazhdon të jetë relativisht i lartë. Rritja e aktivitetit ekonomik vendor po përshejtohet, pak shpejt se që pritej sipas projeksioneve të fundit. Mbështetja kreditore për ekonominë vendase nga bankat vazhdon, por rritja është më mesatare dhe në përputhje me pritshmëritë. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë po përmirësohet dhe mundëson mbajtjen e rezervave valutore në zonën e sigurt. Megjithatë, **vazhdojnë të jenë të theksuara rreziqet e mjedisit të jashtëm të pasigurt dhe të ndryshueshëm që lidhen me luftën në Ukrainë.** *Banka Popullore ndjek me kujdes të dhënat dhe rreziqet makroekonomike dhe është e gatshme të përdorë të gjitha instrumentet e nevojshme dhe të marrë masa që do të kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor, stabilizimin e pritshmërive inflacioniste dhe stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm.*

I. Lëvizjet makroekonomike


1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar

Aktiviteti ekonomik global në tremujorin e parë të vitit 2023 shënoi zhvillime përgjithësisht më të favorshme, pavarësisht pasigurisë ende të pranishme për shkak të luftës në Ukrainë, inflacionit të lartë, shtrëngimit të mëtejshëm të politikës monetare dhe përkeqësimit të kushteve financiare globale. Për dallim nga këto prire globale, në Eurozonë, që është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, rritja ekonomike në tremujorin e parë u ngadalësua sërish në 1,0% në bazë vjetore (1,8% në tremujorin e katërt të një viti më parë), si rezultat i uljes së kontributit të konsumit dhe të eksporteve neto. Inflacioni në nivel global në tremujorin e dytë të vitit 2023 vazhdon të ketë dinamikë më të ngadaltë të rritjes, për shkak të uljes së çmimeve të produkteve parësore në tregjet botërore, në kushtet kur efektet e shpenzimeve të larta të energjisë dhe pengesat në furnizim po zhduken ngadalë. Mirëpo, duke pasur parasysh pritshmëritë se inflacioni do të qëndrojë mbi nivelin e objektivit për një periudhë më të gjatë, gjatë tremujorit të dytë, bankat qendrore në vendet e zhvilluara vijuan të shtrëngojnë politikën monetare. Sipas parashikimeve të korrikut të vitit 2023 të Bankës Botërore, rritja ekonomike globale pritet të ngadalësohet në 2,1% në vitin 2023, në kushtet e shtrëngimit të vazhdueshëm të politikës monetare që synon shtypjen e inflacionit të lartë. Më 2024 dhe 2025 pritet përshpejtimi i rritjes ekonomike, që është projektuar në 2,4%, përkatësisht 3,0%. Në të njëjtën kohë, krahasuar me projeksionet e janarit, në përputhje me realizimet më të mira, rritja për vitin 2023 është rishikuar për t'u rritur, ndërsa për vitin 2024 është bërë një korrigjim për të rënë, gjatë rreziqeve ende në rënie.

Në tremujorin e parë të 2023, aktiviteti ekonomik global shënon lëvizje përgjithësisht më të favorshme pavarësisht realizimeve të ndryshme nga vende dhe rajone të veçanta dhe në kushtet e pasigurisë ende të pranishme për shkak të luftës në Ukrainë, inflacionit të lartë, shtrëngimit të mëtejshëm të politikës monetare dhe përkeqësimit të kushteve financiare globale. Në kuadër të **vendeve të zhvilluar**, rritja vjetore ekonomike në ShBA dhe Japoni u përshpejtua në 1,6%, përkatësisht 1,8% (0,9%, përkatësisht 0,4% në tremujorin e katërt të një viti më parë). Përshpejtimi i rritjes në ShBA është kryesisht për shkak të kërkesës neto për eksport, gjatë rritjes më të lartë të eksporteve të shoqëruara me rënien e importeve, ndërsa në Japoni, rritja është nxitur kryesisht nga konsumi i amvisërive. Nga ana tjetër, në Eurozonë, rritja vazhdon të ngadalësohet në 1,0% (1,8% në tremujorin e mëparshëm), e ndikuar nga ngadalësimi i rritjes së konsumit vendor, ndërkaq ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar thuhet se ngjyhet (rritje prej 0,2 %, kundrejt 0,6% në tremujorin e mëparshëm). Në grupin e **ekonomive me rritje të shpejtë**, në tremujorin e parë të këtij viti u forcua aktiviteti ekonomik , kryesisht në Indi, ku, nën ndikimin e rritjes së investimeve bruto, rritja vjetore arriti në 6,1% (4,6% në tremujorin e mëparshëm), dhe rihapja e ekonomisë kineze dhe rritja e konsumit nxitën rritjen në Kinë në 4,5% (2,9% në tremujorin e mëparshëm).





Sa u përket vlerësimeve për rritjen globale në tremujorin e dytë të vitit 2023, vlera mesatare e indeksit PMI global është 53,8 (51,7 në tremujorin e parë), duke sinjalizuar lëvizje më të favorshme të aktivitetit ekonomik botëror në periudhën e ardhshme. Ndryshimi në rritje i indeksit vjen si pasojë e lëvizjeve më të favorshme në sektorin e shërbimeve. Në bazë vjetore, indeksi global PMI shënoi një rritje prej 3,4%.



Rritja ekonomike globale¹ pritet të ngadalësohet në 2,1% më 2023, në kushtet e shtrëngimit të vazhdueshëm të politikës monetare për të shtypur inflacionin e lartë. Prandaj, kushtet e shtrënguara financiare globale dhe ulja e kërkesës së jashtme janë faktorët kryesorë për rritjen e ngadaltë në vendet në zhvillim dhe ekonomitë me rritje të shpejtë. Përsheptimi i rritjes ekonomike pritet në vitin 2024 dhe 2025, i cili parashikohet në 2,4%, përkatësisht 3,0%. Në të njëjtën kohë, krahasuar me projeksionet e janarit, pritshmëritë për vitin 2023 janë rishikuar për rritje prej 0,4 p.p., ndërsa për vitin 2024, projeksioni është rishikuar për rënie e 0,3 p.p. Inflacioni parashikohet të ngadalësohet gradualisht, me kërkesë të dobët agregate dhe lëvizje në rënie të çmimeve të produkteve parësore, me kusht që pritshmëritë afatgjata të inflacionit të mbeten të qëndrueshme. Rreziqet ndaj rritjes së projektuar ekonomike botërore janë kryesisht në rënie dhe lidhen me trazirat në sektorin bankar, shtrëngimin e mundshëm më të fortë të politikës monetare - nëse trysnitë inflacioniste mbijetojnë më gjatë se që pritet - përshkallëzimin e mundshëm i luftës në Ukrainë dhe rritja e cenueshmërisë së vendeve me borxhe të larta.

¹ Analiza në këtë seksion bazohet në raportin e Bankës Botërore për perspektivat ekonomike globale, të publikuar në qershor të vitit 2023

Inflacioni në nivel global në tremujorin e dytë të vitit 2023 vazhdon të shënojë dinamikë më të ngadalhtë të rritjes gjatë trysnive më të dobëta të çmimeve, në kushte kur efektet e shpenzimeve të larta për energjinë dhe pengesat në furnizim po zhduken ngadalë. Nga grupi i vendeve të zhvilluara, inflacioni u ngadalësua më së shumti në Eurozonë dhe ShBA, kryesisht nën ndikimin e komponentit energjetik, i cili uli inflacionin mesatar vjetor në tremujorin e dytë në 6,2% në Eurozonë dhe 4,0% në ShBA. Në periudhën prill - maj, inflacioni në Mbretërinë e Bashkuar u ul në 7,9%.




Eurozona, si partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, regjistroi rritje vjetore të aktivitetit ekonomik prej 1,0% në tremujorin e parë të vitit 2023, pas rritjes prej 1,8% në tremujorin e fundit të vitit 2022. Dinamika e ngadalësuar e rritjes ekonomike rezulton kryesisht nga rritja më e dobët e konsumit të amvisërive dhe rënia e konsumit publik, si dhe nga eksportet neto, në kushtet e një ngadalësimi më të fortë të aktivitetit të eksporteve sesa të importit. Sipas këtyre lëvizjeve, në projeksionet e qershorit të BQE-së është bërë rishikim minimal në rënie për vitin 2023 dhe 2024, ndërsa për vitin 2025 projeksioni është i pandryshuar. Kështu, në vitin 2023 pritet një rritje e aktivitetit ekonomik prej 0,9%, pas së cilës parashikohet përsheptim i caktuar i rritjes, i projektuar në 1,5%, më 2024 dhe 1,6%, më 2025.² Lëvizjet e tregut të punës në Eurozonë po tregojnë përmirësim të mëtijshëm, kështu që norma e papunësisë në prill-maj 2023 është në nivelin historik më të ulët prej 6,5%, (6,6% në tremujorin e parë të vitit 2023). Inflacioni në Eurozonë shënoi ngadalësim të mëtijshëm në tremujorin e dytë, duke u ulur në mesatarisht 6,2% për këtë periudhë (8,0% në tremujorin e parë të 2023), në kushtet e rënies së çmimeve të energjisë, ngadalësimit mesatar të rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe të stabilizimit të inflacionit bazë. Rritja e çmimeve në këtë periudhë përcaktohet kryesisht nga komponenti bazë, i cili shpjegon pothuajse dy të tretat e inflacionit. Në të njëjtën kohë, projeksionet e qershorit të BQE-së tregojnë një rishikim minimal në rritje të rrugës së ardhshme të inflacionit, pra pritet që inflacioni të jetë 5,4% më 2023, 3,0% më 2024 dhe 2,2% më 2025³.

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, duke pasur parasysh pritshmëritë se inflacioni do të mbetet mbi nivelin e objektivit për një periudhë më të gjatë, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara vazhduan të shtrëngojnë politikën monetare, por me një forcë më mesatare në krahasim me tremujorin e mëparshëm nga FED-i dhe BQE-ja, dhe me të njëjtën dinamikë nga Banka e Anglisë. FED-i, pas rritjes së normës referencë të interesit për 0,25 p.p. në maj, në qershor vendosi ta mbajë në të njëjtin nivel, që e bën të lëvizë në një interval nga 5,0% në 5,25%. Përveç kësaj, FED-i vazhdoi të reduktojë më tej portofolin e saj të letrave me vlerë të thesarit dhe të hipotekave. Banka e Anglisë rriti për 0,25 p.p. përkatësisht 0,5 p.p normën referencë të interesit në maj dhe qershor, duke arritur në 5,0%. Gjithashtu, gjatë tremujorit të dytë u realizua edhe programi i shitjes së mjeteve përmes uljes së portofolit të vlerave me vlerë në bilancin e bankave kombëtare. BQE-ja gjatë tremujorit të dytë rriti në dy raste që të tre normat bazë të interesit, secilën për 0,25 p.p., me ç'rast në qershor, norma e interesit për operacionet bazë të rifinancimit, kreditë e disponueshme njëditore dhe depozitat e disponueshme, u pozicionua në nivelin 4,0%, 4,25%, përkatësisht 3,5%. Në të njëjtën kohë, në përputhje me dinamikën e parashikuar dhe të përcaktuar, BQE-ja ka reduktuar gradualisht portofolin në

² Në projeksionet e marsit të vitit 2023, rritja e projektuar e aktivitetit ekonomik ishte 1,0% më 2023 dhe 1,6% më 2024 dhe 2025


³ Në mars të vitit 2023, inflacioni i Eurozonës ishte projektuar në 5,3% më 2023, 2,9% më 2024 dhe 2,1% më 2025.

kuadër të Programit të Blerjes së Letrave me Vlerë (APP), dhe nga korriku i këtij viti do të ndalojë riinvestimin e letrave me vlerë të maturuara në kuadër të këtij programi.



Në tremujorin e dytë të vitit 2023, vlera e dollarit amerikan kundrejt euros vazhdoi të ulet, pra shënoi një nënçmim prej 1,5% krahasuar me tremujorin e parë, që pasqyron pjesërisht politikën monetare më kufizuese në Eurozonë. Në bazë vjetore, vlera e dollarit amerikan kundrejt euros është ulur për 2,2%, duke arritur në 0,92 euro mesatarisht gjatë kësaj periudhe.

Çmimet e produkteve primare shënojnë rënie në bursat botërore në tremujorin e dytë të vitit 2023. Kështu, çmimi mesatar i naftës në këtë periudhë zbriti në 71,7 euro për fuçi, që është më i ulët për 6,6% krahasuar me tremujorin e parë, pra për 31,8% në bazë vjetore. Ndryshimi i kështillë në çmimin e naftës në bursë u nxit nga shqetësimet në lidhje me perspektivat e rritjes së aktivitetit ekonomik botëror, pavarësisht kërkesës më të lartë pas rihapjes së ekonomisë kineze dhe vendimit të OPEC+ për të ulur ofertën. Te çmimet e produkteve primare joenergjetike⁴ (e shprehur në euro), rënia në tremujorin e dytë është 4,5% krahasuar me tremujorin e parë. Sipas grupit të produkteve, indekset e çmimeve të metaleve bazë⁵ dhe të ushqimit⁶ shënuan rënie prej 10,8%, përkatësisht 2,8%.




Në raport me vendet e rajonit, rritja e aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë të vitit 2023 vazhdoi me një dinamikë përgjithësisht më mesatare, me përjashtim të Kosovës dhe Serbisë, ku vërehet një përshpejtim i lehtë i rritjes. Në të njëjtën kohë, rritja e përshpejtuar në Kosovë është rezultat i rritjes së investimeve bruto që kanë pasur një kontribut negativ në tremujorin e mëparshëm, ndërsa në Serbi kjo është për shkak të realizimit më të mirë të eksporteve neto, kryesisht për shkak të rënies së importeve gjatë kërkesës më të ulët vendore. Për sa i përket inflacionit, në të

⁴ Ky indeks agregat përfshin indeksin e metaleve të çmuara, indeksin e ushqimeve dhe të pijeve, indeksin e mallrave bujqësore dhe indeksin e metaleve bazë.

⁵ Në këtë indeks përfshihen metalet e mëposhtme: alumini, kobalti, bakri, hekuri, plumbi, molibdeni, nikeli, kallaji, uranumi dhe zinku.

⁶ Ky indeks përfshin këto produkte ushqimore primare: drithëra, vaj vegjetal, mish, ushqim deti, sheqer dhe ushqime të tjera

gjitha vendet e analizuara të rajonit, në tremujorin e dytë të vitit 2023, vihet re një trajektore në rënie e inflacionit, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2023, e kushtëzuar më së shumti nga rënia e çmimeve të energjisë elektrike dhe rritja e ngadaltë e çmimeve të ushqimeve dhe e inflacionit bazë.



1.2. Oferta vendase

Në tremujorin e parë të vitit 2023, aktiviteti në ekonominë vendase shënoi një rritje reale prej 2,1% në bazë vjetore, që paraqet përshpejtim në raport me rritjen prej 0,6% në tremujorin paraardhës. Rritja në këtë tremujor është në masën më të madhe edhe rezultat i kontributit pozitiv të grupit të aktiviteteve "tregti, transport dhe hoteleri", i cili tashmë në tremujorin e tretë të vitit të kaluar tejkaloi nivelin e arritur në periudhën e parapandemisë. Kontributi pozitiv shtesë ndaj rritjes pati rritja e aktivitetit në ndërtimtarë, informacione dhe komunikime dhe në një masë më të vogël në industri dhe aktivitete financiare. Të dhënat me frekuencë të lartë në kahun e ofertës që janë të disponueshme për periudhën prill-maj 2023 tregojnë kryesisht rritje të mëtejshme të aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit, por me dinamikë më mesatare. Vlerësimet e drejtuesve për situatën e biznesit të ndërmarrjeve për tremujorin e dytë të vitit 2023 janë më të favorshme në të gjithë sektorët e rëndësishëm të ekonomisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si dhe më të favorshme janë edhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme.

Në tremujorin e parë të vitit 2023, rritja reale e ekonomisë vendase ishte 2,1% me bazë vjetore, që paraqet përshpejtim në krahasim me rritjen prej 0,6% në tremujorin paraardhës (gjatë rritjes tremujore prej 2,4%, e përshtatur sezonale). Nga pikëpamja strukturore, rritja vjetore në tremujorin e parë i detyrohet kryesisht kontributit pozitiv të grupit të aktiviteteve "tregti, transport dhe hoteleri", i cili edhe në tremujorin e tretë të vitit të kaluar tejkaloi nivelin e realizuar gjatë periudhës së parapandemisë. Pas lëvizjeve negative të vërejtura në tremujorin e mëparshëm, një kontribut pozitiv shtesë në rritjen e PBB-së në këtë tremujor kishin aktiviteti më i lartë në sektorin e ndërtimit, informacioneve dhe komunikimeve, industrisë dhe aktiviteteve financiare. Nga ana tjetër, bujqësia, veprimtaria "administrata publike dhe mbrojtja, arsimi, mbrojtja shëndetësore dhe sociale" dhe arti kanë kontribut negativ.

**PBB dhe komponentët - shkallët vjetore të rritjes (në %)**

	norma vjetore të rritjes, në %*																
	2018	2019	2020	2021	2022	Tr.1 2020	Tr.2 2020	Tr.3 2020	Tr.4 2020	Tr.1 2021	Tr.2 2021	Tr.3 2021	Tr.4 2021	Tr.1 2022	Tr.2 2022	Tr.3 2022	Tr.4 2022
Bujqësia	8.3	0.1	2.5	-5.2	2.0	4.0	5.4	6.1	-3.4	-1.7	-5.7	-3.6	-8.5	1.6	4.3	3.5	-0.9
Industria	5.3	1.4	-6.7	0.9	-1.5	-4.7	-23.9	-5.1	7.0	-6.5	10.9	-0.7	1.3	-4.1	0.7	-1.7	-1.1
nga të cilat te industria përpunimit	6.2	2.6	-4.8	7.9	-1.8	-1.4	-26.9	-1.9	11.2	0.3	23.6	5.7	5.5	-2.5	1.9	-2.9	-3.2
Ndërtimtaria	-11.0	5.5	-4.0	-5.5	-8.4	1.6	-14.5	1.6	-3.8	0.8	-3.6	-3.7	-11.0	-16.7	-1.0	-9.1	-8.1
Tregtia, transporti dhe komunikacioni dhe hotelleria	5.0	6.7	-10.6	4.3	7.8	-1.0	-30.2	-6.2	-4.8	-11.2	31.5	2.7	1.1	7.4	6.4	9.1	8.3
Informacione dhe komunikime	-4.1	6.8	4.5	15.9	2.6	11.9	-3.7	5.0	5.2	10.7	21.4	13.6	18.0	6.6	7.3	-0.7	-2.0
Ndërmjetësim financiar	2.6	0.4	-0.1	-0.9	1.3	2.1	-4.6	0.5	1.7	-1.5	2.5	-4.2	-0.1	1.0	-0.7	5.8	-0.9
Veprimtari e lidhur me patundshmëritë	0.1	0.2	1.1	8.3	4.1	3.5	-2.7	-1.0	4.6	6.1	9.5	7.8	9.9	4.7	7.2	3.1	1.3
Veprimtari administrative dhe shërbime ndihmëse	7.9	8.0	-8.7	15.4	8.7	-8.1	-11.3	-11.1	-4.2	7.6	17.6	19.8	17.2	17.1	12.1	5.6	0.5
Drejtoria publike	2.0	5.2	3.2	5.6	0.0	2.3	3.2	2.7	4.4	2.5	6.4	6.9	6.4	2.1	0.9	-0.9	-1.9
Art, argëtim dhe rekreacion; Veprimtari tjera shërbimi	6.6	9.6	-22.6	23.5	11.0	-14.0	-23.2	-32.9	-20.0	3.1	22.8	39.9	32.2	17.7	14.2	11.8	1.5
Produkti bruto i brendshëm	2.9	3.9	-4.7	3.9	2.1	-0.3	-15.4	-4.3	1.3	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0	0.6

*Nga njoftimi i PBB-së nga 5.6.2023

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

PBB-ja dhe komponentët - kontributet në rritjen e PBB-së (në p.p.)


	kontributi në rritjen e PBB-së, në p.p.																
	2018	2019	2020	2021	2022	Tr.1 2020	Tr.2 2020	Tr.3 2020	Tr.4 2020	Tr.1 2021	Tr.2 2021	Tr.3 2021	Tr.4 2021	Tr.1 2022	Tr.2 2022	Tr.3 2022	Tr.4 2022
Bujqësia	0.7	0.0	0.2	-0.4	0.1	0.3	0.4	0.5	-0.3	-0.1	-0.5	-0.4	-0.8	0.2	0.3	0.2	-0.1
Industria	0.9	0.3	-1.2	0.2	-0.3	-0.9	-4.4	1.2	-1.1	1.8	-0.1	0.2	-0.7	0.1	-0.3	-0.2	0.1
nga të cilat te industria përpunimit	0.8	0.3	-0.6	1.1	-0.2	-0.2	-3.7	-0.3	1.5	0.0	2.8	0.8	0.8	-0.3	0.3	-0.4	-0.5
Ndërtimtaria	-0.7	0.3	-0.2	-0.3	-0.5	0.0	-0.8	0.1	-0.2	0.1	-0.1	-0.3	-0.8	-0.8	-0.1	-0.5	-0.4
Tregtia, transporti dhe komunikacioni dhe hotelleria	1.0	1.3	-2.1	0.8	1.5	-0.2	-6.1	-1.2	-1.0	-2.3	5.3	0.6	0.2	1.4	1.2	1.8	1.6
Informacione dhe komunikime	-0.1	0.2	0.2	0.6	0.1	0.4	-0.1	0.2	0.2	0.4	0.9	0.5	0.7	0.3	0.3	0.0	-0.1
Ndërmjetësim financiar	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0
Veprimtari e lidhur me patundshmëritë	0.0	0.0	0.1	0.9	0.4	0.4	-0.3	-0.1	0.4	0.7	1.1	0.8	0.9	0.5	0.8	0.3	0.2
Veprimtari administrative dhe shërbime ndihmëse	0.3	0.3	-0.3	0.6	0.3	-0.3	-0.4	-0.4	-0.1	0.3	0.7	0.7	0.6	0.7	0.5	0.2	0.0
Drejtoria publike	0.2	0.6	0.4	0.7	0.0	0.3	0.4	0.3	0.5	0.4	1.0	0.9	0.7	0.3	0.1	-0.1	-0.2
Art, argëtim dhe rekreacion; Veprimtari tjera shërbimi	0.2	0.3	-0.7	0.6	0.3	-0.4	-0.7	-1.0	-0.5	0.1	0.7	0.9	0.7	0.5	0.4	0.3	0.0
Produkti bruto i brendshëm	2.9	3.9	-4.7	3.9	2.1	-0.3	-15.4	-4.3	1.3	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0	0.6

*Nga njoftimi i PBB-së nga 5.6.2023


Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Burimi: Llogaritjet e BPRMV-së.

Analizuar përmes të dhënave me frekuencë të lartë, **në tremujorin e parë të vitit, qarkullimi total në tregti shënoi rritje reale me bazë vjetore**, në kushte të rritjes në të tre llojet e tregtisë (tregtia me shumicë, pakicë dhe tregtia e automjeteve). Në periudhën prill-maj 2023, qarkullimi në tregtinë totale shënoi rënie reale vjetore, me rënie në tregtinë me pakicë dhe me shumicë, ndërsa tregtia e automjeteve shënoi rritje. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e “tregtisë me pakicë” për situatën e biznesit, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, janë më të favorshme, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, ndërsa më të favorshme janë edhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme.





Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.




Burimi: Anketa e KE-së për tregtinë me pakicë, Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Në tremujorin e parë të vitit 2023 vërehen lëvizje në drejtime të ndryshme në **transport**. Kështu, rritje vërehet në të gjitha llojet e komunikacionit të pasagjerëve (komunikacioni hekurudhor, ajror dhe rrugor), ndërsa rënie vërehet në të gjitha llojet e komunikacionit të mallrave (komunikacioni hekurudhor,

rrugor dhe ajror), që në një masë të caktuar mund të lidhet me realizimet më të dobëta në disa nga aktivitetet tradicionale industriale.



Në kuadër të **sektorit të hotelierisë**, në tremujorin e parë të vitit 2023 vazhdoi rritja reale me bazë vjetore e numrit të turistëve dhe natëqëndrimeve, por me dinamikë më të ngadaltë në krahasim me tremujorin e mëparshëm, ndërkohë që rënie është vërejtur në qarkullimin total, që vjen si pasojë e bazës më të lartë krahasuese. Njëkohësisht, në numrin e turistëve dhe natëqëndrimeve, rritja ka ardhur tërësisht si pasojë e rritjes së numrit dhe natëqëndrimeve të turistëve të huaj, në kushtet e udhëtimit më të lehtë, ndërsa rënie vërehet në numrin dhe natëqëndrimet e turistëve vendas. Të dhënat e muajit prill të vitit 2023 tregojnë një përsheptim të ndjeshëm të rritjes së numrit dhe të natëqëndrimeve të turistëve, ndërkohë që rënia e qarkullimit total real në hotelieri vazhdon, por me një dinamikë më mesatare. Në të njëjtën kohë, vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e shërbimeve, për situatën e tyre të biznesit, në tremujorin e dytë të vitit 2023 janë më të favorshme në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, si dhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme, për sa i përket kërkesës, janë gjithashtu më të favorshme.




Në tremujorin e parë të vitit, prodhimi industrial⁷ shënoi rritje reale minimale prej 0,1% me bazë vjetore (pas rënies prej 3,4% në tremujorin e mëparshëm), si rezultat i një kontributi pozitiv të sektorit të energjisë, ndërsa sektori i prodhimit dhe i minierave shënuan kontribut negativ. Sipas veprimtarive, një kontribut pozitiv më të theksuar kanë disa nga veprimtaritë ku kapacitetet e mëdha të eksportit të huaj janë aktive, si prodhimi i automjeteve, ndërsa kontribut pozitiv shtesë kanë edhe prodhimi i produkteve bazë farmaceutike, preparateve farmaceutike dhe prodhimi i lëkurës. Nga

⁷ Analiza e lëvizjeve në industri është bërë në bazë të të dhënave mujore për indekset e prodhimit industrial të EShS-së.


ana tjetër, kontributi më i madh negativ vihet re në disa nga veprimtaritë tradicionale, kryesisht te ato me energji më të fuqishme, si prodhimi i metaleve, ndërsa kontribut negativ shtesë kanë prodhimi i produkteve metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve, si dhe prodhimi i produkteve të gomës dhe produkteve të masës plastike. Në periudhën prill-maj 2023, prodhimi industrial shënoi një rritje reale vjetore prej 2,3%, si rezultat i kontributit pozitiv të sektorit të energjisë dhe industrisë përpunuese, ndërsa minierat kanë një kontribut të vogël negativ. Drejtuesit e sektorit industrial kanë vlerësime më të favorshme për situatën e biznesit në tremujorin e dytë të vitit 2023, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, si dhe pritshmëritë në aspekt të lëvizjeve të prodhimit në periudhën e ardhshme janë më të favorshme.

Kontributet e veprimtarive të zgjedhura ndaj ndryshimit vjetor të prodhimit industrial (në pikë përqindje)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe BPRMV-ja.

Sipas të dhënave të disponueshme me frekuencë të lartë, **në tremujorin e parë të vitit 2023, aktiviteti në sektorin e ndërtimit shënoi rritje reale të lartë me bazë vjetore, pas realizimeve të dobëta në dy vitet e fundit.** Në të njëjtën kohë, rritja në totalin e punimeve të ndërtimit vjen si pasojë e rritjes së lartë, si në ndërtimet e larta, ashtu edhe në ato të ulëta. Rritja në ndërtimtari mund të shoqërohet me rritjen e aktiviteteve të projekteve të infrastrukturës publike të nisura, por edhe në përgjithësi me stabilizimin e çmimeve të materialeve të ndërtimit, si dhe me kushtet e favorshme atmosferike. Nga ana tjetër, në muajin prill, vlera e punimeve të ndërtimit të kryera në bazë vjetore shënoi rënie të thellë, në kushtet e rënies, si në ndërtimet e larta, ashtu edhe në ato të ulëta. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimit për lëvizjen e veprimtarisë të tyre në tremujorin e dytë të vitit 2023 janë më të favorshme, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa të favorshme janë edhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme.




1.3. Kërkesa agregate


Nga këndvështrimi i kërkesës, rritja reale vjetore e PBB-së prej 2,1%, në tremujorin e parë të vitit 2023, rezulton tërësisht nga eksportet neto, gjatë rritjes solide të eksporteve dhe rënies së importeve. Prandaj, eksporti vazhdon të jetë komponenti me kontributin më të lartë pozitiv individual në rritjen e përgjithshme ekonomike. Kërkesa vendore ka dhënë një kontribut negativ në rritje, kryesisht si pasojë e rënies së lartë të investimeve bruto, e cila pasqyron kryesisht uljen graduale të inventarëve, të rritura më parë për shkak të rritjes së rreziqeve globale. Rënie shënoi edhe konsumi publik, ndërsa konsumi personal shënoi rritje të mtejshme vjetore, por me dinamikë më të ngadaltë, mbështetur nga rritja më e fortë e transfereve private dhe rënia më mesatare e pjesës së komponentëve të tjerë të të ardhurave reale të disponueshme.

Analiza strukturore e PBB-së⁸ Nga pikëpamja e kërkesës, kjo tregon se rritja në tremujorin e parë të vitit 2023 i detyrohet tërësisht kontributit pozitiv të eksporteve neto, në kushtet e rritjes solide të eksporteve dhe të rënies së importeve. Kërkesa vendore ka një kontribut negativ, kryesisht si pasojë e rënies së lartë të investimeve bruto, ndërkohë që rënie shënon edhe konsumi publik, me rritjen e ngadaltë të konsumit personal.

⁸ Ndryshimet tremujore në PBB dhe komponentët e tij janë llogaritur nga të dhënat e rregulluara sezonale.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe vlerësimet e BPRMV-së.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

	Normat vjetore të rritjes reale (në%)													Kontribute ndaj rritjes reale vjetore (në p.p.)**												
	2019	2020	2021	2022	2021-Tr.1	2021-Tr.2	2021-Tr.3	2021-Tr.4	2022-Tr.1	2022-Tr.2	2022-Tr.3	2022-Tr.4	2023-Tr.1	2019	2020	2021	2022	2021-Tr.1	2021-Tr.2	2021-Tr.3	2021-Tr.4	2022-Tr.1	2022-Tr.2	2022-Tr.3	2022-Tr.4	2023-Tr.1
Konsumi privat	3.5	-3.6	8.3	3.1	2.8	15.9	5.6	9.0	2.5	1.5	5.4	3.0	2.5	2.5	-2.3	5.3	2.1	1.9	11.3	3.7	5.7	1.7	1.0	3.6	2.0	1.7
Konsumi publik	2.5	9.8	-0.4	-2.6	-4.5	0.6	0.3	1.8	2.7	-5.2	-4.7	-2.8	-5.9	0.4	1.4	-0.1	-0.4	-0.8	0.2	0.0	0.2	0.4	-0.9	-0.7	-0.4	-1.0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	8.9	-10.9	11.7	13.4	7.1	44.8	3.7	1.3	11.3	14.2	17.8	10.2	7.1	5.4	-6.8	6.8	8.9	4.2	22.4	2.2	0.8	7.6	9.6	11.9	6.4	5.3
Importi i mallrave dhe shërbimeve	10.1	-10.9	11.9	16.1	0.0	43.8	0.9	11.6	21.2	19.8	19.4	6.5	-4.3	-7.3	8.3	-8.4	-13.2	0.0	-26.2	-0.6	-8.5	-16.5	-15.9	-15.3	-6.2	4.1
Investimet bruto	8.7	-15.1	1.7	15.0	-15.5	35.2	-11.3	10.1	31.8	41.5	9.0	-5.3	-22.9	3.1	-5.2	0.3	4.9	-4.9	7.2	-3.5	3.5	9.0	10.2	2.5	-1.3	-8.4
Kërkesa e brendshme	4.9	-5.5	5.5	5.4	-3.1	17.2	0.4	8.5	9.5	9.0	5.0	-0.2	-5.8	5.9	-6.1	5.5	6.5	-3.8	18.7	0.2	9.4	11.1	10.3	5.3	0.3	-7.6
Eksporti neto*	13.7	-10.7	12.4	23.9	-19.2	40.8	-7.3	40.4	56.9	37.8	24.8	-1.1	##	-2.0	1.5	-1.6	-4.4	4.2	-3.8	1.6	-7.8	-8.8	-6.3	-3.4	0.2	9.4
Mospërputhje statistikore														0.0	0.0	0.0	0.0	-0.3	-0.4	-0.3	-0.4	0.0	0.0	0.0	0.1	0.4
PBB	3.9	-4.7	3.9	2.1	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0	0.6	2.1	3.9	-4.7	3.9	2.1	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0	0.6	2.1

* u lla e eksportit neto tregon ngushtim të deficitit.

** Kontributet sipas komponentëve nuk shtohen në PBB-në reale shkaku i mospërputhjes statistikore në shumat aktuale.

Me qëllim që të përshtatet me normat zyrtare reale të rritjes, PBB-ja agregate përfshin mospërputhje statistikore.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

1.3.1 Konsumi personal


Në tremujorin e parë të vitit 2023, konsumi personal vazhdoi të rritet, por më ngadalë, duke regjistruar një rritje vjetore prej 2,5% dhe një rënie tremujore prej 1,3% (rritje vjetore prej 3% dhe një rënie tremujore prej 0,1%, në tremujorin paraardhës). Rritja e konsumit vazhdon të mbështetet nga transferet private. Nga ana tjetër, masa e pensione⁹, rroga e paguar mesatare¹⁰ dhe kreditimi i popullsisë nga bankat shënuan edhe në këtë tremujor rënie vjetore sipas treguesve realë, ndonëse më pak në krahasim me periudhën paraardhëse, në përputhje me ngadalësimin e shkallës së inflacionit. Në kushtet e pasigurisë nga lufta në Ukrainë dhe mbajtjes së çmimeve të konsumit në nivele të larta, gjatë këtij tremujori u miratuan masa shtesë ekonomike për

⁹ Në mars të vitit 2023, pensionet u rritën nominalisht për 8,4%, në pajtim me harmonizimin e rregullt të parashikuar me metodologjinë e re që ndjek dy tregues, pra 50% të rritjes së rrogës mesatare dhe 50% të rritjes së shpenzimeve të jetesës, sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikës. Ky harmonizim bëhet dy herë në vit, në mars dhe shtator (për më tepër kë këtë [link](#)). Gjithashtu, në pajtim me pakon e re të masave të synuara për të ndihmuar grupet më të cënueshme të qytetarëve, të miratuar në tetor të viti 2022, në 4 muajt e ardhshëm (nëntor e dhjetor 2022, si dhe janar e shkurt 2023) janë paguar nga 1.500 denarë për pensionistët që marrin deri në 11.525 denarë pension dhe 750 denarë për pensionistët që marrin nga 11.525 deri në 14.000 denarë pension.

¹⁰ Më hollësisht në pjesën 1.3. Punësimi dhe rrogat.

mbrojtjen e standardit të jetesës¹¹ të cilat ndoshta patën kontribut të pjesshëm në ruajtjen e konsumit të amvisërive.

Nga aspekti i të dhënave të disponueshme për lëvizjet në konsumin personal¹² në tremujorin e dytë të vitit 2023, ngadalësohet rënia reale vjetore e kredive për popullatën, kurse te disa nga komponentët e të ardhurave të disponueshme, përkatësisht te rrogat dhe pensionet¹³, për herë të parë pas një viti, vihet re një rritje e vogël. Rezultatet e Anketës së aktivitetit kreditor të muajit qershor tregojnë një ashpërsim neto të kushteve të përgjithshme të kredisë dhe një ulje neto të kërkesës së kredive totale të amvisërive. Gjithashtu, në këtë periudhë, rënie në bazë reale kishte edhe tregtia me pakicë dhe të hyrat bruto nga TVSh-ja. Nga ana tjetër, prodhimi vendas i mallrave të konsumit dhe importi i mallrave të konsumit të gjerë shënuan rritje. Sa i përket treguesit të besimit të konsumatorit¹⁴, ai tregon një perspektivë më të favorshme për tremujorin e dytë të vitit 2023, si në raport me tremujorin e mëparshëm, ashtu edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Në tremujorin e dytë të vitit, në kushtet e pasigurisë së zgjatur, u miratuan masa shtesë ekonomike për mbrojtjen e standardit të jetesës së qytetarëve¹⁵.



¹¹ Më 26 dhjetor 2022, në pajtim me Buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë për vitin 2023, u siguruan mjete për të përballuar krizën energjetike dhe për të mbështetur amvisëritë dhe kompanitë, ndërkohë që vazhduan edhe masa për ngrirjen e marzheve të produkteve ushqimore bazë deri në fund të prillit të vitit 2023. Edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 vazhduan masat ekonomike shtesë për mbrojtjen e standardit të jetesës. Kështu, më 7 shkurt 2022, Qeveria vendosi të vazhdonte subvencionet për faturat e energjisë elektrike për kategoritë më të cenueshme të qytetarëve me nga 600 deri në 800 denarë, sipas kriterëve të dhëna. Më 28 shkurt 2023, Qeveria vendosi për ngrirjen e çmimit të bukës në 33 denarë, nga 31 maji 2023. Në fillim të marsit të vitit 2023, Qeveria vendosi për ngrirjen e çmimeve të makaronave dhe të bulmetit. Në të njëjtën kohë, çmimi i makaronave u ul për 15%, krahasuar me çmimin e zbatuar në tregtinë me pakicë më 1 mars 2023, ndërsa çmimet e bulmetit u ulën për 10%. Vendimi është i vlefshëm nga 16 marsi 2023 dhe do të zbatohet deri më 31 maj 2023. Më 21 mars 2023 u vendos për ngrirjen e çmimeve të vezëve, që vliente nga 1 prilli deri më 31 maj 2023. Më 29 mars 2023, çmimet e letrës higjienike, jastëkëve, pecetave të lagura, pelenave ngrinë dhe ulen për 13%, që vliente nga 1 prilli deri më 31 maj 2023. Në fillim të muajit prill, disa vendime ngrinë çmimet e disa llojeve të fruta-perimeve, si dhe përcaktohen sasi të minimale që tregtarët duhet të ofrojnë.

¹² Të dhënat për rrogat janë të prillit 2023, ndërsa të dhënat për kreditë e popullsisë, pensionet, tregtinë me pakicë, prodhimin vendas të mallrave të konsumit, importet e mallrave të konsumit të gjerë dhe të hyrat bruto nga TVSH-ja i referohen periudhës prill-maj 2023.

¹³ Në pajtim me pakon e masave të synuara për të ndihmuar grupet më të cenueshme të qytetarëve, të miratuar në tetor, në dy muajt e parë të vitit 2023 (janar dhe shkurt) është planifikuar të paguhet nga 1.500 denarë për pensionistët që marrin deri në 11.525 denarë pension dhe 750 denarë për pensionistët që marrin nga 11.525 deri në 14.000 denarë pension.


¹⁴ Sondazhi i Komisionit European për optimizmin e konsumatorëve, përfshi qershorin 2023. Në pasqyrën grafike, indeksi i besimit të konsumatorit shfaqet si përqindje neto e përgjigjeve. Ky indeks është një komponent përbërës të indeksit të përgjithshëm të besimit ekonomik.

¹⁵ Edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, masat ekonomike për mbrojtjen e standardeve të jetesës vazhduan të zbatohen. Kështu, çmimi i bukës së bardhë dhe gjysëm të bardhë është ngrirë që nga 1 marsi 2023; çmimet e disa makaronave dhe disa bulmetrave janë ulur dhe ngrirë që nga 16 marsi, me heqjen e njëkohshme të doganave të makaronave dhe që nga 1 prilli janë ulur dhe ngrirë çmimet e produkteve të caktuara higjienike. Këto masa u zbatuan deri më 31 maj 2023. Gjithashtu, për periudhën 21 mars deri në fund të prillit 2023 është ngrirë çmimi i vezëve të pulës dhe i orizit. Për më shumë hollësi në këtë link: <https://vlada.mk/sednici>.

1.3.2. Konsumi publik

Konsumi publik shënoi rënie reale vjetore edhe në tremujorin e parë të vitit 2023, që ishte 5,9% (rënie prej 4,8% në bazë tremujore). Sipas të dhënave të buxhetit, rënie reale në këtë periudhë shënuan thuajse të gjitha kategoritë kryesore të konsumit publik, para së gjithash shpenzimet për rrogat, fondin e shëndetësisë dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime.

Realizimet buxhetore në përputhje me të dhënat fiskale për periudhën prill - maj 2023 tregojnë rënien reale vjetore të **konsumit publik** edhe në tremujorin e dytë të vitit, në kushte të rënies në thuajse të gjitha kategoritë kryesore (përveç transfereve te qeverisja vendore).



Burimi: Ministria e Financave dhe Llogaritjet e BPRMV-së.

Në llogaritjet janë marrë shpenzimet e publikuara në buxhetin e konsoliduar të Qeverisë Qëndrore dhe Fondeve, të deflatuara nga kostoja e jetës



1.3.3. Konsumi i investimeve

Rënia e investimeve bruto u thellua në tremujorin e parë të 2023. Në të njëjtën kohë, investimet shënuan rënie reale vjetore dhe tremujore prej 22,9%, përkatësisht 9,4%. Lëvizje të tilla nga viti në vit pasqyrojnë inventarë më të ulët, d.m.th shterimin e rritjes nga viti i kaluar, kur inventarët u rritën, si përgjigje ndaj efekteve negative të luftës në Ukrainë dhe të pasigurisë në tregun e energjisë. Nga ana tjetër, nga këndvështrimi i kategorive treguese për investime në mjete bazë, në këtë periudhë është vërejtur rritje reale në punimet e kryera ndërtimore, prodhimin vendas të mallrave kapitale dhe të hyrat nga tatimi mbi fitimin. Në kategoritë e tjera treguese u vërejtën ndryshime reale negative (në kreditë afatgjata për ndërmarrjet, importin e mjeteve për punë, investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe investimet kapitale shtetërore).

Sa u përket të dhënave me frekuencë të lartë për investimet bruto¹⁶ për periudhën prill-maj 2023, rënie reale vjetore shënojnë importet për mjete pune, të hyrat nga tatimi mbi fitimin dhe kreditë afatgjata të ndërmarrjeve. Nga ana tjetër, rritje e lartë u vu re në investimet kapitale shtetërore, sipas financimit për ndërtimin e infrastrukturës rrugore¹⁷ të korridoreve 8 dhe 10D, ndërkaq rritje mesatare u vërejt në prodhimin vendas të mallrave kapitale. Gjithashtu, rezultatet e Anketës së aktivitetit kreditor për tremujorin e dytë tregojnë një ashpërsim neto të kushteve të përgjithshme të kreditimit dhe një rritje të lehtë neto të kërkesës për kredi të korporatave.

¹⁶ Të dhënat e punimeve të përfunduara ndërtimore dhe inventarët e produkteve të gatshme janë të prillit të vitit 2023, ndërsa të dhënat e kredive afatgjata për ndërmarrjet, investimet kapitale shtetërore, prodhimin industrial, importin e produkteve të investimeve dhe prodhimin vendas të produkteve kapitale i referohen periudhës prill - maj 2023.



¹⁷ Sipas programit për financimin e infrastrukturës rrugore për projektin Korridori 8 dhe Korridori 10D, për vitin 2023, i miratuar në seancën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më 23 mars të këtij viti, si dhe pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare, Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore (NPRrSh) bëri transferin e parë në llogarinë e kontraktorit të pjesëve të autostradave, në shumë prej 7.254.000.000 denarë ose 117.000.000 euro nga buxheti i shtetit, përmes Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjeve. <https://360stepeni.mk/bochvarski-na-jpdp-mu-se-isplateni-prvite-117-milioni-evra-za-proektot-so-behtel-i-enka/>



1.3.4. Kërkesa neto e eksportit

Në tremujorin e parë të vitit 2023, eksportet neto patën një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së, në kushtet e rritjes solide të eksporteve dhe të rënies së importeve. Eksporti vazhdon të rritet në baza vjetore, duke realizuar shkallë të rritjes prej 7,1%, gjatë rritjes tremujore prej 6,6% (rritje vjetore prej 10,2%, përkatësisht rënie tremujore prej 3,6% në tremujorin pararendës). Kështu, ky tremujor ishte edhe komponenti me kontributin më të lartë pozitiv individual në rritjen e PBB-së. Analizuar sipas vlerave nominale të statistikave të tregtisë së jashtme, kontributin më të madh në realizimet e këtyre kanë kompanitë me pronësi të huaj që kanë të bëjnë me industrinë e automjeteve, me orientim nga eksporti, kurse kontribut pozitiv shënon edhe eksporti i energjisë. Mungesa e nevojës për import për inventarët, si dhe rritja më mesatare e konsumit personal dhe e eksporteve, kontribuan në uljen e totalit të importeve për 4,3% me bazë vjetore në tremujorin e parë (me një rënie tremujore prej 1,9%).

Të dhënat e këmbimit tregtarë me jashtë në periudhën prill-maj 2023 tregojnë një ngushtim të deficitit në tremujorin e dytë të vitit, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, gjatë rritjes së eksporteve dhe rënies së importeve të mallrave.



1.4. Punësimi dhe rrogat

Sipas të dhënave të reja nga Anketa për fuqinë punëtore, në tremujorin e parë të vitit 2023, shkalla e punësimit është 45,1%, dhe shkalla e papunësisë është 13,3%. Gjatë kësaj periudhe, përsheptimi i aktivitetit ekonomik u pasqyrua edhe në tregun e punës, vështruar nëpërmjet rezultateve të anketave për prirjet biznesore të cilat tregojnë pritshmëri më të favorshme të drejtuesve të kompanive për punësime të reja në tremujorin e parë, krahasuar me pritshmëritë e një viti më parë. Pritshmëritë për periudhën e ardhshme janë të favorshme, si në baza tremujore, ashtu edhe në ato vjetore. Rrogat në tremujorin e parë të vitit 2023 vazhduan të rriten, por me një dinamikë më mesatare.

Në këtë raport tremujor, për shkak të ndryshimeve metodologjike në anketë dhe disponueshmërisë së të dhënave vetëm për një tremujor në Anketën për fuqinë punëtore¹⁸ (tremujori i parë i vitit 2023), lëvizjet e tregut të punës nuk mund të analizohen në mënyrë të duhur dhe mund të jepet një pasqyrë e ndryshimeve në krahasim me periudhën e mëparshme. Kështu, sipas të dhënave të reja, në tremujorin e parë të vitit 2023, shkalla e punësimit është 45,1%, shkalla e aktivitetit është 52%, dhe shkalla e papunësisë është 13,3%.

Në përputhje me përsheptimin e aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë të vitit 2023, rezultatet e vrojtimeve të prirjeve biznesore ishin më të favorshme për sa i përket pritshmërive për numrin e të punësuarve në tremujor, krahasuar me pritshmëritë për tremujorin paraardhës dhe krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. **Sinjalet nga anketa, për prirjet biznesore¹⁹, janë kryesisht më të favorshme** edhe në aspekt të pritshmërive për numrin e të punësuarve në tre muajorin e ardhshëm. Pritshmëritë janë optimiste në të gjithë sektorët, por janë më të theksuara në shërbime dhe industri.




¹⁸ Të dhënat e fuqisë punëtore për trm. 1 të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të mëparshëm të viteve të tjera sepse më 2023 EShS zbatoi rregulloren e re të BE-së. Zbatimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në anketë, duke filluar nga ndryshimet në hartimin e pyetësorit, ndryshimi i renditjes së pyetjeve, ndryshimi dhe heqja e pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në fushëveprimin dhe përcaktimin e punësimit dhe të papunësisë. Ndryshimet e përmendura shkaktuan ndërprerjen e serive kohore të të dhënave. Për këtë arsye, edhe ky raport është në formë të modifikuar dhe të shkurtuar, derisa të merren të dhënat e përpunuara dhe të harmonizuara për vitet e kaluara.

¹⁹ Burimi: Komisioni European, anketa për prirjet biznesore, pritshmëritë e punësimit në tre muajt e ardhshëm në industri, shërbime, tregti me pakicë dhe ndërtimtarë (anketime të kryera në prill, maj dhe qershor të vitit 2023).

Shkalla e vendeve të lira të punës²⁰ është ruajtur në një nivel relativisht të qëndrueshëm për një periudhë më të gjatë kohore, siç ishte edhe në tremujorin e parë të vitit 2023. Për këtë periudhë është **1,9%** (1,8% në tremujorin përkatës të vitit 2022). Sipas veprimtarive, shkalla më e lartë e vendeve të lira konstatohet në "veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe ndihmëse" (3,7%), "transport" (2,6%), "ndërtimtari" (2,5%), "veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike" (2,3%), "industri përpunuese" (2,2%) dhe "tregti" (2,1%).

Rrogat mesatare neto dhe bruto të paguara në tremujorin e parë shënuan rritje vjetore prej 12,9%, përkatësisht 13,2% (në tremujorin e mëparshëm, rritje prej 13,9%, përkatësisht 14,1%). Në përpuzhje me rregulloret ligjore, rritja vjetore e rrogave është pjesërisht rezultat i rritjes së rrogës minimale prej 12,6%, në mars të vitit 2023, dhe rrjedhimisht, i rritjes lineare prej 2.175 denarë të rrogave në administratën shtetërore, për shkak të harmonizimit të rrogave me minimumin²¹. Gjithashtu, në rritje ndikon edhe efekti transferues i rritjes së rrogave në një pjesë të sektorit publik²² në shtator të vitit 2022, si dhe vazhdimësia e disa faktorëve strukturorë, si mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara të tregut të punës. Megjithatë, përkundër të gjithë faktorëve të përmendur, rritja nominale vjetore është në ngadalësim, gjatë rritjes më mesatare të rrogave minimale në këtë vit, krahasuar me rritjen në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Analizuar sipas veprimtarive, rritje e rrogave vjetore është vërejtur në të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe veçanërisht në: "ndërtim", "transport", "objekte akomodimi dhe shërbime ushqimore", "informacione dhe komunikime", "arsim" dhe "industri prodhuese". Në kushtet e rritjes së çmimeve të konsumit prej 16,1%, **rrogat reale neto dhe bruto në tremujorin e parë janë më të ulëta për 2,8%, përkatësisht 2,5%, në bazë vjetore.** Në prill të vitit 2023, rritja vjetore e rrogës mesatare nominale neto u përshpejtua lehtë dhe arriti në 14,6%, ndërsa rroga neto reale regjistroi një rritje të lehtë prej 1,4%, për herë të parë pas njëmbëdhjetë muajsh të rënies së vazhdueshme.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

*Të dhënat në tremujorin e 2.2023 janë me të dhënat e fundit prill 2023.

²⁰ Shkalla e vendeve të lira të punës është raporti midis numrit të vendeve të lira dhe numrit të përgjithshëm të vendeve të punës. Zakonisht, shkalla e punës shqyrtohet së bashku me shkallën e papunësisë (një marrëdhënie e njohur si lakorja e Beverixhit). Vendosja e këtyre dy treguesve jep informacion për efikasitetin e tregut të punës nga aspekti i mospërputhjeve të mundshme midis profileve të kërkuara dhe atyre të disponueshme në tregun e punës në një moment të caktuar (ang. skill mismatches). Konkretisht, nëse të dy treguesit lëvizin në të njëjtën kohë, bëhet fjalë për luhatje të përkohshme, ciklike, ndërsa në rastin kur shkalla e papunësisë ulët, me një normë të qëndrueshme të vendeve të lira, bëhet fjalë për ndryshime strukturorë, pra për efikasitet më të mirë të tregut të punës.

²¹ Në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e rrogës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 58/23) nga marsi 2023, rroga minimale neto u rrit për 2.175 denarë. Lartësia e rrogës minimale në shumën bruto, duke filluar nga marsi i vitit 2023 deri në shkurt të vitit 2024, është 29.739 denarë (më parë 26.422 denarë), përkatësisht rroga minimale në shumën neto është 20.175 denarë (më parë 18.000 denarë). Kjo rritje është llogaritur në pajtim me metodologjinë e vitit të kaluar, me të cilën do të harmonizohet rroga minimale, por llogaritet në pajtim me rritjen e vitit të mëparshëm të rrogës mesatare të paguar në RMV dhe indeksit të shpenzimeve të jetesës – përkatësisht 50% e rritjes së secilit tregues. Gjithashtu, u përcaktua që rroga minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e shumës së rrogës mesatare neto të paguar në RMV gjatë vitit të mëparshëm.


²² Në pajtim me ribalancin e Buxhetit, rroga e shtatorit ka një rritje prej 15% për punonjësit në drejtësi, arsimin e mesëm dhe fillor dhe kujdesin ndaj fëmijëve; 7% rritje të rrogave për punonjësit në arsimin e lartë dhe 5% rritje të rrogave për punonjësit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në shëndetësi.

1.5. Inflacioni

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, shkalla e inflacionit vazhdoi të ngadalësohet në bazë vjetore dhe ishte mesatarisht 11,2%. Rritje e ngadaltë e çmimeve vendore vërehet në të tri kategoritë kryesore – ushqime, energji dhe inflacion bazë. Gjatë kësaj periudhe, në bursat botërore vazhdoi lëvizja në rënie e çmimeve të produkteve ushqimore bazë dhe të produkteve energjetike, me shtrëngim të mëtijshëm të politikës monetare dhe të masave ekonomike për zbutjen e presioneve mbi çmimet e produkteve ushqimore. Nga pikëpamja e faktorëve që do të ndikonin në dinamikën e ardhshme afatshkurtër të çmimeve të konsumit, në tremujorin e dytë të vitit 2023 vihet re një ngadalësim i shkallës së rritjes së çmimeve të prodhuesve vendas dhe inflacionit të importuar nga jashtë. Në aspekt të pritshmërive për shkallën e inflacionit në periudhën në vijim, sipas Anketës së Bankës Popullore, parashikimet e analistëve ekonomikë vazhdojnë të jenë në drejtim të ngadalësimit gradual të tij dhe janë kryesisht në përputhje me dinamikën e projektuar të inflacionit nga Banka popullore dhe institucionet ndërkombëtare.

1.5.1. Inflacioni aktual

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, shkalla e inflacionit vazhdoi të ngadalësohet me bazë vjetore dhe ishte mesatarisht 11,2% (16,1% në tremujorin e mëparshëm)²³. Ndikimin më të madh në këtë dinamikë e ka rritja e ngadaltë e çmimeve të ushqimeve, e plotësuar nga trajektorja në rënie e rritjes së çmimit të energjisë dhe të inflacionit bazë.



Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-

Inflacioni bazë në tremujorin e dytë të vitit 2023 u ul në nivel njëshifror dhe ishte 9,1%, me bazë vjetore, pas arritjes së kulmit në tremujorin e mëparshëm (10,2%). Kjo dinamikë pasqyron kryesisht shkallët më të ulëta të rritjes së çmimeve të shërbimeve hotelerike, produkteve të higjienës personale dhe shërbimeve të transportit, gjatë rritjes së ngadalësuar të shpenzimeve të ushqimit dhe të energjisë. Megjithatë, çmimet e shërbimeve të restoranteve dhe hoteleve mbeten shtytësi kryesor i inflacionit bazë, duke kontribuar afërsisht për një të katërtën e rritjes. Kontribut të rëndësishëm kanë çmimet e produkteve të higjienës personale, produkteve të pastrimit dhe të mirëmbajtje së rregullt të amvisërive, pijeve joalkoolike, duhanit dhe veshjeve. Nënindekset e tjera të inflacionit, të cilët përjashtojnë çmimet më të luhatshme, shënuan gjithashtu ngadalësim të rritjes në këtë tremujor, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Kështu, te indeksi total, duke mos përfshirë energjinë²⁴, lëndët djegëse dhe lubrifikantët e lëngshëm (për transport), si dhe ushqimet e papërpunuara, vërehet një rritje

²³ Në bazë tremujore, çmimet e konsumit vendor janë më të larta për 1,4%, ndërkaj në bazë të rregulluar sezonale, për 0,7%.

²⁴ Kategoria "energji" i referohet energjisë elektrike, gazit, lëndëve djegëse të lëngshme dhe të ngurta për ngrohje dhe ngrohjes qendrore.



vjetore prej 11,2% (15,8% në tremujorin paraardhës), ndërsa te indeksi total, duke përfshirë energjinë, lëndët djegëse dhe lubrifikantët e lëngshëm (për transport), ushqimet e papërpunuara, duhanin dhe pijet alkoolike, shkalla vjetore e rritjes është 11,4% (16,6% në tremujorin paraardhës).

	(ndryshime vjetore, në%)								(kontribute ndaj ndryshimeve vjetore, në p.p.)								
	2021	2022					2022	2023		2021	2022				2022	2023	
		Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1		Tr.2	Tr.1		Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1		Tr.2	
Tregues i çmimeve të konsumit - gjithsej	3.2	7.7	12.3	17.2	19.3	14.2	16.1	11.2	3.2	7.7	12.3	17.2	19.3	14.2	16.1	11.2	
Храна	3.3	10.4	18.0	26.7	30.3	21.5	24.6	14.5	1.2	3.8	6.7	9.9	11.4	8.0	9.0	5.5	
Çmimet e energjisë	6.4	13.4	17.8	25.5	23.6	20.2	15.3	9.2	0.8	1.8	2.3	3.4	3.1	2.7	2.0	1.2	
Energjia elektrike	4.3	9.4	9.4	20.2	20.2	14.8	14.0	14.0	0.3	0.7	0.7	1.5	1.5	1.1	1.0	1.0	
Ngrohja qendrore	-1.7	9.4	9.4	23.0	30.1	17.8	14.2	14.2	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	
Lëndët djegëse të lëngëta dhe lubrifikantë	17.4	29.1	42.0	37.7	21.2	32.3	4.2	-14.3	0.5	0.9	1.4	1.3	0.8	1.1	0.1	-0.4	
Ushimi dhe energjia (çmime të luhatshme)	4.1	11.2	18.0	26.4	28.6	21.2	22.2	13.2	2.0	5.6	9.1	13.2	14.5	10.7	11.0	6.7	
Inflacioni bazë i llogaritur nga BPRMV-ja (treguesi total - ushqimi dhe energjia (kategoritë 01,1, 04,5, 07,2,2))	2.4	4.2	6.5	7.9	9.8	7.1	10.2	9.1	1.2	2.1	3.2	3.9	4.8	3.5	5.2	4.5	
Treguesi total duke përjashtuar energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët dhe ushqimin e papërpunuar (ESHS)	2.7	6.0	10.4	15.1	17.6	12.3	15.8	11.2									
Treguesi total duke përjashtuar energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët, ushqimin e papërpunuar, duhanin dhe pijet alkoolike (ESHS)	2.6	6.1	10.5	15.7	18.2	12.7	16.6	11.4									


Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Ngadalësimi i rritjes vjetore të çmimeve të ushqimeve vazhdoi në tremujorin e dytë të vitit 2023, me forcë të shtuar. Rritja e çmimeve u zvogëluar nga 24,6% në 14,5%, në tremujorin e parë, në kushtet e ngadalësimit të rritjes së çmimeve në shumicën e produkteve ushqimore, më së shumti si pasojë e çmimeve në kategoritë “bukë dhe drithëra” dhe “qumësht, djathë dhe vezë”, të cilat shpjegojnë pothuajse dy të tretat e ngadalësimit të ushqimit. Megjithatë, rritja vjetore e çmimeve në këto kategori mbetet dyshifrore dhe së bashku me çmimet më të larta të mishit, në tremujorin e dytë vazhdojnë të kontribuojnë më së shumti në rritjen e çmimeve të komponentit ushqimor. Nga ana tjetër, çmimi i vajit shënoi rënie, gjatë një lëvizjeje të vazhdueshme në rënie të çmimit në bursat botërore. Gjatë kësaj periudhe vazhdoi lëvizja në rënie e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun ndërkombëtar, si dhe trysnia e reduktuar e burimeve të energjisë mbi shpenzimet operative në industrinë ushqimore, në kushtet e lëvizjeve të favorshme të çmimeve të energjisë elektrike dhe të derivateve të naftës. Krahas kësaj, në tremujorin e dytë, çmimet e shitjes së prodhuesve vendas të ushqimeve dhe çmimet e huaja efektive të ushqimeve, të shprehura në euro, shënuan ngadalësim të shkallës vjetore të rritjes²⁵. Gjithashtu, për zbutjen e trysnive në çmimet e produkteve ushqimore, u zbatuan masat për ngrirjen e çmimeve të kategorive të caktuara të produkteve ushqimore bazë dhe marzhat tregtare²⁶.

²⁵ Të dhënat e çmimeve të shitjes së prodhuesve vendas të ushqimeve dhe çmimeve të huaja efektive të ushqimeve u referohen dy muajve të parë të tremujorit të dytë të vitit 2023.

²⁶ Më 28 shkurt 2023, Qeveria e RMV-së vendosi për ngrirjen e çmimit të bukës në periudhën nga 1 marsi deri më 31 maj 2023. Kështu, çmimi i bukës së bardhë dhe gjysmë të bardhë prej 450 gram e më shumë u ngrirë në nivelin nga 33 denarë, përkatësisht deri në 33 denarë për bukën e bardhë dhe gjysmë të bardhë nën 450 gram, në raport me peshën e bukës. Në të njëjtën kohë, qeveria mori vendim për heqjen e çmimit të subvencionuar të energjisë elektrike për kompanitë e industrisë ushqimore. (linku). Më 10 mars, Qeveria mori vendim për uljen, përkatësisht ngrirjen e çmimeve të disa makaronave dhe disa bulmetrave në periudhën nga 16 marsi deri më 31 maj 2023. Kështu, çmimet e makaronave dhe shpagetave u ulën me 15%, krahasuar me ato të zbatuara në tregtinë me pakicë më 1 mars dhe u ngrinë në atë nivel deri në fund të majit. Krahas kësaj, u mor vendim për heqjen e taksës doganore për makaronat për periudhën nga 13 marsi deri më 31 maj 2023, në mënyrë që, në pajtim me vlerësimet e paraqitura, efekti i heqjes së taksës doganore të përkojë me shumën e uljes së çmimit të makaronave. Çmimet e bulmetrave si: qumështi i përhershëm i lopës (me përmbajtje yndyre 2,8%, 3,2% dhe 3,5%), gjiza, djathi i bardhë i lopës/përzier, djathi i lopës, kosi, ajka dhe jogurti u ulën për 10%, krahasuar me çmimet që mbizotëronin në tregtinë me pakicë më 1 mars dhe ishin ngrirë në atë nivel gjatë zbatimit të masës. (linku). Më 21 mars, Qeveria mori vendim për ngrirjen e çmimeve të vezëve të freskëta të pulës dhe të orizit në nivelin që vlente më 15 mars në tregtinë me pakicë, të cilat u zbatuan deri më 30 prill 2023. (linku). Gjithashtu, Qeveria mori një vendim më 3 prill (linku), ndërsa më 11 prill ndryshim vendimi (linku) për të përcaktuar çmimet më të larta të shitjes me pakicë të frutave dhe perimeve, duke përfshirë domatet, kastravecet, qepët, lulëlakrën, specat, fasulet, thjerrëzat, bananet, portokallet, mandarinat dhe limonët. Kjo masë ishte fillimisht e vlefshme për periudhën nga 5 deri më 30 prill dhe më pas u vendos që masa të zbatohet deri më 31 maj 2023. (linku). Krahas ndërhyrjeve në çmimet e produkteve ushqimore, më 29 mars, Qeveria mori vendim për uljen, përkatësisht ngrirjen e çmimeve të një pjese të caktuar të produkteve higjienike për periudhën nga 1 prilli deri më 31 maj 2023. Kështu, çmimet e letrës higjienike, pecetave të lagura, pelenave dhe pecetave higjienike u ulën për 13%, krahasuar me ato të zbatuara në tregtinë me pakicë më 20 mars dhe u ngrinë në atë nivel për aq sa zgjati kjo masë. (linku). Gjithashtu, më 25 prill, Qeveria mori vendim që të vazhdojë zbatimin e marzheve më të larta tashmë të përcaktuara tregtare në tregtinë me shumicë dhe pakicë për disa produkte ushqimore deri më 30 qershor 2023. (linku).

Ngadalësimi i rritjes së çmimit të energjisë vazhdoi edhe në tremujorin e dytë të vitit 2023, me ç'rast rritja vjetore e çmimeve u ul në nivel njëshifror prej 9,2% (15,3% në tremujorin e mëparshëm). Kjo dinamikë është, para së gjithash, rezultat i rënies së çmimeve vendore të derivateve të naftës, të cilat pasojnë lëvizjen në rënie të çmimit të naftës bruto në bursat botërore. Shtytës kryesor i rritjes së çmimeve në komponentin e energjisë në tremujorin e dytë janë çmimet e energjisë elektrike për amvisëritë, rritja e të cilave vjen nga efekti i transferuar i rritjes së çmimeve rregullatore në korrik të një viti më parë dhe rritja në janar²⁷, ndërkaq edhe çmimet e drurit për ngrohje janë më të larta.




Në tremujorin e dytë të vitit 2023, **çmimet e prodhuesve të produkteve industriale** shënuan rritje prej 6,3% me bazë vjetore²⁸, që vazhdoi dinamikën e ngadaltë të rritjes së çmimeve të prodhimit (10,5% në tremujorin paraardhës). Kjo rrugë e lëvizjes vjen më së shumti nga rënia e çmimeve të prodhimit të produkteve të ndërmjetme (pa energjinë), me ç'rast rënie të çmimeve shënojnë edhe grupi i produkteve kapitale. Nga pikëpamja strukturore, nxitësi kryesor i rritjes së çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale në këtë tremujor janë çmimet e energjisë, të ndjekura nga çmimet e prodhimit të pijeve dhe produkteve ushqimore. Çmimet më të larta të energjisë pasqyrojnë efektin transferues të rritjes së lartë të çmimit në korrik të vitit të kaluar, për kompanitë e tregut rregullator, pavarësisht korrigjimit në rënie të bërë në janar të vitit 2023²⁹ dhe në kushtet kur çmimi i energjisë elektrike në tregun e lirë është në rënie. Në drejtim të kundërt vepruan uljet e çmimeve të prodhimit të metaleve dhe mineraleve, çmimet e bursave të të cilave kanë pasur një lëvizje në rënie gjatë kësaj periudhe. **Çmimet e prodhimit të energjisë dhe të produkteve të konsumit të gjerë**, si kategori e mbledhur dhe një nga faktorët që ndikojnë në dinamikën e çmimeve të konsumit, shënuan rritje vjetore më të ngadaltë, që është 10,8% (11,1% në tremujorin paraardhës). **Inflacioni efektiv i huaj**³⁰, si tregues dëshmuës i inflacionit të importuar, gjithashtu shënon dinamikë të ngadaltë të rritjes, që është 8,8% (10,5% në tremujorin e mëparshëm).

²⁷ Në pajtim me vendimin e Komisionit Rregullator të Energjetikës (KRRE), në janar të vitit 2023 u bënë këto ndryshime në çmimin e energjisë elektrike për furnizuesin universal: çmimi në bllokun e parë dhe të dytë u ul për 4,11%, përkatësisht 2,95%, ndërsa çmimi në bllokun e tretë dhe të katërt u korrigjua në rritje për 0,85%, përkatësisht 7,65%. (njoftim), kurse çmimi i tarifës së ulët u rrit nga 0,6193 den/kWh më parë, në 1,3183 den/kWh (çmimet). Krahas kësaj, nga janari i vitit 2023 norma e taksës për shitjen e energjisë elektrike për amvisëritë është 10%, në vend të 5%, sa ishte gjatë një viti e gjysmë të kaluar. Në korrik të vitit të kaluar, kur u prezantua modeli me katër tarifa, çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal u rrit mesatarisht për 9,9% (tarifa e ulët ppr 8,8% dhe tarifa e lartë për mesatarisht 10,4%).


²⁸ Analiza e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale u referohet dy muajve të parë të tremujorit të dytë të vitit 2023.

²⁹ Në pajtim me njoftimin e KRRE-së (linku), nga janari i vitit 2023, çmimi i energjisë elektrike u ul për 20,15% për mbi 70 mijë kompani të vogla që janë në tregun e rregulluar. E njëjta, në korrik të vitit 2022, sipas përllogaritjeve, u rrit ppr 50,7%, përkatësisht 18,4% në tarifën e lartë dhe të ulët, krahasuar me tarifën e vetme më parë.

³⁰ Përllogaritja e inflacionit të jashtëm efektiv është nxjerrë nga shuma e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve partnere më të rëndësishme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të mallrave të konsumit të gjerë. Struktura ponderuese bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili prej vendeve, në totalin e importit nominal në periudhën 2016-2018. Në përllogaritjen e këtij treguesi u përfshinë Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Polonia dhe Spanja. Të dhënat u referohen dy muajve të parë të tremujorit të dytë të vitit 2023.



Në tremujorin e dytë të vitit 2023, u vërejt **ngadalësim** i mëtejshëm i **ritjes së çmimeve të apartamenteve**, të llogaritura sipas indeksit edonik³¹, që janë më të larta për 12,9% me bazë vjetore (18,8% në tremujorin e mëparshëm). Nga këndvështrimi i ofertës, në tremujorin e parë vihet re një rënie prej 2,0% me bazë vjetore, të vlerës së ndërtesave banesore të ndërtuara, pas një periudhe rritjeje të njëpasnjëshme në tre tremujorët e fundit. Të dhënat e disponueshme për vlerën e lejeve të dhëna për ndërtimin e ndërtesave banesore në tremujorin e dytë të vitit 2023³² për momentin tregojnë një rënie vjetore, pas rritjes së fortë në tremujorin e parë. Nga aspekti i kërkesës për apartamente, vërehet një ngadalësim i mëtejshëm i rritjes vjetore të kredive banesore³³.



1.5.2. Pritshmëritë inflacioniste

Lidhur me ecurinë e pritjeve të normës së inflacionit, institucionet vendase dhe ndërkombëtare parashikojnë prirje në rënie të rritjes së çmimeve të konsumit në periudhën në vijim. Në të njëjtën kahje janë edhe pritshmëritë e analistëve ekonomikë të anketuar në kuadër të **Anketës për pritshmëritë inflacioniste dhe pritshmëritë për lëvizjen e PBB-së reale**³⁴, e realizuar në qershor të vitit 2023, sipas të cilit parashikohet ngadalësim i normës së inflacionit, në nivelin 9,3% në vitin 2023, 5,1% në vitin 2024 dhe 3,4% në vitin 2025. Krahasuar me anketën paraprake, normat e pritjeve të inflacionit janë më

³¹ Indeksi hedonik i çmimeve të apartamenteve, i përpiluar nga BPRMV, mbi bazën e shpalljeve për shitje në kryeqytet, ndërkaq i publikuar nga agjencitë që merren me qarkullimin e pasurive të paluajtshme. Çmimi i apartamentit është në funksion të zonës, lagjes në të cilën ndodhet, katit, nëse apartamenti ka ngrohje qendrore dhe nëse apartamenti është i ri.

³² Analiza i referohet muajit të parë të tremujorit të dytë të vitit 2023.

³³ Të dhënat e disponueshme për dy muajt e parë të tremujorit të dytë të vitit 2023.

³⁴ Duke filluar nga tetori i vitit 2017, BPRMV-ja bëri ndryshim në anketën hulumtuese të deritashme "Anketa e pritjeve të inflacionit". Anketa e re "Anketa mbi pritshmëritë inflacioniste dhe pritshmëritë mbi lëvizjen e PBB-së reale" është kryer mbi kampion analistësh ekonomikë, dhe lënda e Anketës është e zgjeruar, në pajtim me praktikën e Bankës Qendrore Europiane (BQE).

të ulëta. Në të njëjtën kohë, pasiguria që lidhet me dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursat botërore, veçanërisht në tregjet e ushqimit dhe energjisë, është ende e pranishme për shkak të zhvillimeve ushtarake në Ukrainë dhe sanksioneve ndaj Rusisë.

Projektimet dhe parashikimet për normën e inflacionit

	2023	2024	2025
Analistë ekonomik	9.3	5.1	3.4
FMN	9.2	3.5	2.3
Consensus Forecast	8.7	3.5	/
Ministria e Financave	8.9	2.5	2.0
BPRMV-ja	8-9	2.4	/


Burimi: Anketa për parashikimet inflacioniste dhe parashikimet për lëvizjen e PBB-së reale, shtator 2023; FMN-ja, Pasqyra ekonomike botërore, prill 2023; Consensus Forecast, qershor 2023; Ministria e Financave, Strategjia fiskale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 2024-2028, prill, 2023; dhe BPRMV-ja prill 2023.

Tendencë të ngjashme shfaqin edhe pritshmëritë afatshkurtra të konsumatorëve dhe udhëheqësve të ndërmarrjeve në aktivitete të caktuara për lëvizjet e çmimeve, të shprehura në anketat e tremujorit të dytë të vitit 2023. Në përgjithësi, trysnitë më të dobëta nga çmimet e ushqimeve dhe energjisë kanë efekt të favorshëm në perceptimet dhe pritshmëritë e subjekteve ekonomike për inflacionin. Sipas **"pritjeve të konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm"**³⁵, pritshmëritë janë në drejtimin e rënies së çmimeve si reflektim i rritjes të numrit të njerëzve që besojnë se në 12 muajt e ardhshëm do të ketë rënie ose do të ketë çmime të pandryshuara, në raport me numrin e njerëzve që presin çmime më të larta. Lidhur me pritshmëritë e **sektorit të ndërmarrjeve**³⁶, në tremujorin e dytë vihet re rënie e mëtejshme e raportit të udhëheqësve të ndërmarrjeve në industrinë përpunuese dhe të ndërtimit të cilët presin rritje të çmimeve të produkteve të tyre në tre muajt e ardhshëm, ndërsa në tregtinë me pakicë dhe sektorin e shërbimeve ka rritje të lehtë të këtij raporti në krahasim me tremujorin paraardhës, ku pritshmëritë në tregtinë me pakicë janë disi më pak të favorshme në krahasim me aktivitetet tjera.

Parashikimet inflacioniste të konsumatorëve (bilanci përgjigjeve)



Parashikimet inflacionare të drejtuesve të ndërmarrjeve (bilanci i përgjigjeve)



1.6. Bilanci i pagesave

Në tremujorin e parë të vitit 2023, llogaria rrjedhëse shënoi suficit prej 0,9% të PBB-së, performancë e ndryshme nga dinamika e zakonshme sezonale dhe më së shumti reflekton ecuri më të mirë të të ardhurave dytësore dhe deficit më të ulët tregtar. Në bazë vjetore, deficitin në shkëmbimin e mallrave është më i ulët për 2,4 p.p. të PBB-së, dy herë më pak se vitin e kaluar, e cila vjen më së shumti nga rënia e komponentit të importit, për 2,3

³⁵ Anketa e Komisionit European për optimizmin e konsumatorëve, përfshirë qershorin e vitit 2023.

³⁶ Anketa e prirjeve biznesore të Komisionit European në industri, tregtia me pakicë, ndërtim dhe shërbime përfshirë, qershorin e vitit 2023.



p.p. të PBB-së, me rritje minimale të njëkohshme prej 0,1 p.p. të PBB-së mbi eksportet. Tryshtë e reduktuara të importit vijnë kryesisht nga importi i energjisë, respektivisht nga importi i energjisë elektrike, për shkak të rritjes së prodhimit vendas dhe konsumit më të ulët të energjisë. Në drejtim të ngushtimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse kanë funksionuar edhe të ardhurat dytësore, suficiti i të cilave është rritur për 1,1 p.p. të PBB-së, si dhe suficiti i rritur në shërbime për 0,5 p.p. të PBB-së, në kushtet e të ardhurave parësore të pandryshuara. Llogaria financiare në tremujorin e parë të vitit regjistroi flukse hyrëse mbi bazën neto, kryesisht si rezultat i flukseve hyrëse neto të realizuara në investimet e portofolit, si rezultat i eurobondit të sapoemetuar të shtetit, dhe në masë më të vogël në investimet e drejtpërdrejta. Flukset hyrëse neto në llogarinë financiare kanë mundur rritje solide të rezervave valutore gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që ato mbeten ende në zonën e sigurt.

	2022					2023	2022					2023
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-XII	Tr.1	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-XII	Tr.1
	Во милиони евра						% од БДП					
I. Llogaria rrjedhëse	-388.8	-234.0	96.6	-246.2	-772.4	122.5	-3.0	-1.8	0.7	-1.9	-6.0	0.9
Mallra dhe shërbime, neto	-680.7	-737.0	-552.6	-741.7	-2712.0	-347.0	-5.3	-5.7	-4.3	-5.8	-21.0	-2.4
Eksport	2139.8	2419.4	2550.0	2554.6	9663.7	2431.3	16.6	18.8	19.8	19.8	74.9	17.1
Import	2820.5	3156.4	3102.5	3296.2	12375.7	2778.3	21.9	24.5	24.1	25.6	95.9	19.6
Mallra, neto	-850.3	-899.4	-881.4	-821.7	-3452.8	-598.8	-6.6	-7.0	-6.8	-6.4	-26.8	-4.2
Shërbimet, neto	169.6	162.3	328.9	80.0	740.8	251.8	1.3	1.3	2.5	0.6	5.7	1.8
Të hyrat primare, neto	-138.7	-136.9	-137.2	-145.3	-558.1	-154.4	-1.1	-1.1	-1.1	-1.1	-4.3	-1.1
Të hyrat sekondare, neto	430.5	639.9	786.4	640.8	2497.6	624.0	3.3	5.0	6.1	5.0	19.4	4.4
II. Llogaria kapitale	0.2	-0.6	-1.1	-2.1	-3.6	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditim neto (+) / debitim neto (-) (zëri përmbledhës nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale)	-388.6	-234.6	95.5	-248.3	-776.1	122.9	-3.0	-1.8	0.7	-1.9	-6.0	0.9
III. Llogaria financiare	-13.3	-74.9	-524.6	-377.9	-990.7	-138.2	-0.1	-0.6	-4.1	-2.9	-7.7	-1.0
Investime direkte	-111.7	-137.7	-181.8	-239.0	-670.2	-113.7	-0.9	-1.1	-1.4	-1.9	-5.2	-0.8
Investime të portofolit	26.4	69.1	-221.7	74.1	-52.1	-438.5	0.2	0.5	-1.7	0.6	-0.4	-3.1
Valuta dhe depozita	24.3	118.5	133.7	107.5	383.9	124.3	0.2	0.9	1.0	0.8	3.0	0.9
Kreditë	53.5	-34.9	-175.1	-210.0	-366.4	166.3	0.4	-0.3	-1.4	-1.6	-2.8	1.2
Kreditë tregtare dhe avanset	-5.1	-86.1	-79.6	-110.2	-281.0	123.9	0.0	-0.7	-0.6	-0.9	-2.2	0.9
Llogari të tjera për arkëtim/pagesa	-0.3	0.0	0.0	-0.3	-0.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IV. Të drejta të veçanta të tërheqjes (krijimi i detyrimeve neto)	0.0	0.2	0.4	0.1	0.7	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
V. Gabime dhe lëshime neto (pa rezerva valutore)	1.8	27.0	33.9	-5.8	57.0	5.6	0.0	0.2	0.3	0.0	0.4	0.0
VI. Rezervat valutore	-373.5	-132.7	654.0	123.8	271.6	266.7	-2.9	-1.0	5.1	1.0	2.1	1.9


Burimi: BPRMV-ja.

1.6.1. Llogaria rrjedhëse

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave shënoi suficit prej 122,5 milionë euro, ose 0,9% e PBB-së³⁷. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, kur u vu re deficit i lartë i llogarisë rrjedhëse (nga 3% të PBB-së), është arritur përmirësim i dukshëm (për 3,9 p.p. të PBB-së) që më së shumti vjen si pasojë e ngushtimit të bilancit negativ në këmbimin e mallrave, me arritje të favorshme edhe në kategoritë e tjera. Konkretisht, deficitit tregtar në


³⁷ Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (që nga prilli 2023).

tremujorin e parë të vitit u ul për 2,4 p.p. të PBB-së në bazë vjetore, nën ndikimin e rënies së komponentit të importit, me 2,3 p.p. të PBB-së, me rritje minimale të njëkohshme prej 0,1 p.p. të PBB-së së eksportit të mallrave. Rënia e importit të mallrave është ndikuar nga rënia e importit të energjisë elektrike, me rritje të prodhimit vendas dhe njëkohësisht konsum më të ulët (pjesërisht dhe nën ndikimin e kushteve të favorshme atmosferike jotipike për muajt e parë të vitit). Gjithashtu, në tremujorin e parë të vitit, u regjistrua import më i ulët i lëndëve të para për industrinë, kryesisht i hekurit dhe çelikut, si dhe xeheve. Për rrjedhojë, rreth 2/3 e ngushtimit të deficitit tregtar vjen nga përmirësimi i bilancit energjetik, me përmirësim të njëkohshëm të bilancit joenergjetik. Në arritjet më të mira të llogarisë rrjedhëse kontribuan edhe të ardhurat dytësore, me intensitet pak më të ulët, suficitit i të cilave u rrit për 1,1 p.p. të PBB-së, e ndikuar kryesisht nga rritja e transfereve private, si dhe rritja e suficitit në shërbime për 0,5 p.p. të PBB-së, si rezultat i suficitit më të lartë në shërbimet e përfundimit dhe shërbimet e tjera të biznesit.



Shtojcë: Tregtia e jashtme e mallrave dhe lëvizja e kursit efektiv nominal dhe real të këmbimit (NEDK dhe REDK)³⁸

Tregtia e jashtme në tremujorin e parë të vitit 2023 arrin në 4.885,4 milionë euro, respektivisht 34,4% të PBB-së. Në terma nominalë, shkëmbimi shënoi rritje prej 107,0 milionë eurosh, me rritje të eksporteve, kundrejt komponentit të importit, i cili shënoi rënie me bazë vjetore.




Në tremujorin e parë të vitit 2023, eksportet e mallrave shënuan rritje prej 9,6% me bazë vjetore. Kjo arritje vjen më së shumti nga kontributi pozitiv i eksportit të pajisjeve dhe makinerive, si rezultat i rritjes së aktivitetit eksportues të kompanive të huaja nga industria e automobilave. Kontribut pozitiv pati edhe në komponentin energjetik, i nxitur nga rritja e eksporteve të energjisë elektrike. Kontribut pozitiv në këtë periudhë shënoi edhe eksporti i produkteve kimike, i cili përfaqëson kategorinë e eksportit të pjesës së kompanive të huaja nga industria e automobilave. Në të njëjtin drejtim veprojnë

³⁸ Sipas Metodologjisë së tregtisë së jashtme, të dhënat për eksportin e mallrave publikohen në f.o.b, dhe për importin e mallrave në bazë c.i.f.


edhe rritja e eksportit të mobiljeve dhe në masë më të vogël eksporti i ushqimeve dhe pijeve dhe industria e tekstilit. Nga ana tjetër, eksportet e hekurit dhe çelikut vazhduan të bien në tremujorin e parë të vitit 2023. **Importet e mallrave në tremujorin e parë të vitit 2023 shënuan rënie prej 2,8% me bazë vjetore, ku faktori kryesor i rënies ishte importi më i ulët i energjisë.** Përsa i përket komponentëve, rënia është shkaktuar nga importi i energjisë elektrike, me rritje të lehtë të njëkohshme të importit të gazit natyror dhe pothuajse të pandryshuar mbi importin e derivateve të naftës. Rënia e importit të energjisë elektrike vjen si pasojë e uljes së ndjeshme të sasive të importuara, në kushtet e prodhimit vendas më të lartë, si dhe kushteve më të mira atmosferike gjatë dimrit. Korrigjim në rënie vihet re edhe në importin e hekurit dhe çelikut, i cili vjen si pasojë e uljes së sasive të importuara dhe çmimeve më të ulëta. Reduktim të caktuar ka edhe në importin e produkteve kimike inorganike gjatë kësaj periudhe. Krahësuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, importe më të larta janë shënuar në kategorinë e pajisjeve dhe makinerive, veçanërisht importet e makinave elektrike. **Arritjet në të dy komponentët e tregtisë së jashtme në tremujorin e parë të 2023 çuan në ngushtim të deficitit tregtar me 29,6% në bazë vjetore, në kushtet e ngushtimit të deficitit si të bilancit energjetik ashtu edhe atij joenergjetik, ku bilanci energjetik shpjegon 70% të rënies.**

Të dhënat më të fundit të disponueshme për periudhën prill-maj 2023 tregojnë për ruajtjen e lëvizjeve të favorshme në bursë që nga fillimi i vitit. Deficiti në tregtinë e jashtme ka vazhduar të zvogëlohet, për 43,2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në kushte të rritjes së eksporteve dhe rënies së importit të mallrave. Rritja vjetore e komponentit të eksportit prej 1,0% rezulton kryesisht nga arritjet e eksportit të sektorit të automobilave me rritjen e eksportit të pajisjeve dhe makinerive, automjeteve rrugore dhe eksportit të mobiljeve, eksportit më të lartë të substancave kimike, si dhe nga rritja e eksportit të energjisë elektrike, kundrejt reduktimit të eksporteve të hekurit dhe çelikut. Importi i mallrave shënoi rënie vjetore prej 13,9% për shkak të uljes së importit të energjisë, uljes së importit të metaleve me ngjyra dhe hekurit dhe çelikut, si dhe importit më të ulët të produkteve kimike inorganike.




Sipas analizës së importit të mallrave nga aspekti i ndarjes sipas Sistemit të Llogarive Kombëtare (System of national accounts – SNA), rënia e importeve në tremujorin e parë të vitit 2023 rezulton nga importet e energjisë, si dhe nga importet e produkteve të ndërmjetme. Rritje shënuan importet e destinuar për konsum personal³⁹, për të cilat kontributin më të madh e ka pasur importi i ushqimeve dhe pijeve (të përpunuara) kryesisht për përdorim shtëpiak, si dhe importi i mallrave të konsumit që nuk përmenden diku tjetër. E analizuar sipas dinamikës, rritja e importeve për konsum personal është e moderuar në tremujorin e parë dhe nuk tregon për presione të theksuara në totalin e importeve.

³⁹ Importet e mallrave për konsum personal analizohen si importe të përcaktuara për konsum personal, të përafëruara me importet e mallrave të konsumit dhe importet e vlerësuara të automjeteve të pasagjerëve për përdorim individual.





E analizuar sipas dinamikës, rritja e importeve për konsum personal është e moderuar në tremujorin e parë dhe për momentin nuk tregon për presione të theksuara në totalin e importeve. Analiza në aspektin e **eksportit** tregon se rritja vjetore në tremujorin e parë është e shpërndarë midis vendeve të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të vendeve të BE-së, kontributin më të madh e ka ende eksporti në Gjermani, i cili më së shumti i detyrohet eksportit të produkteve të ndryshme të industrisë kimike, si dhe eksportit të makinave elektrike. Ndikim pozitiv ka rritja e eksportit të energjisë në Greqi, si dhe rritja e eksportit të automjeteve në Belgjikë. Kontribut pozitiv kanë dhënë edhe eksportet në Serbi si rezultat i eksporteve më të larta të energjisë. Sipas të dhënave për partnerët tregtarë nga ana e importit, analiza tregon se kontributin më të madh në rënien vjetore e ka ulja e **importit** nga Bullgaria, si rezultat i reduktimit të importit të energjisë, dhe në këtë drejtim ndikon edhe importi i produkteve kimike inorganike dhe metalet e çmuara nga Britania e Madhe. Ulje është vërejtur edhe në importin e hekurit dhe çelikut nga Ukraina, Rumania dhe Serbia. Për sa i përket **balanceve** të tregtisë së jashtme sipas partnerëve individualë, ulja e deficitit tregtar në bazë vjetore i detyrohet më së shumti suficitit më të lartë të arritur me Gjermaninë, por edhe rënies së bilancit negativ në këmbimin me Bullgarinë, Serbinë, Greqinë, Ukrainën, Rumaninë, e Madhe, Britaninë dhe Luksemburgun. Nga ana tjetër, ka pasur deficit në këmbimin me ShBA-në, Holandën dhe Shqipërinë krahasuar me suficitin në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, si dhe deficit më të lartë në këmbimin me Kinën.

Eksporti i mallrave sipas vendeve, në tremujorin e 3 të vitit 2023 (pjesëmarrja, në %)





Importi i mallrave sipas vendeve, në tremujorin e 3 të vitit 2023 (pjesëmarrja, në %)






Për sa i përket treguesve të konkurrueshmërisë së çmimeve, në tremujorin e parë të vitit 2023, kursi real efektiv i këmbimit i deflatuar nga shpenzimet e jetesës është mbivlerësuar me 4,1% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i deflatuar nga shpenzimet e prodhuesve industrialë është vlerësuar me 0,9%. Arritjet e tilla janë reflektim i ndryshimeve të çmimeve relative, domethënë të rritjes së shpenzimeve relative të jetesës me 3,6% dhe rritjes së çmimeve relative të prodhuesve të produkteve industriale me 0,5% në bazë vjetore. Kursi nominal efektiv shënoi rritje të vogël vjetore prej 0,4%, si pasojë e nënvlerësimit të lirës turke, pjesërisht e kompensuar nga mbivlerësimi i rublës ruse në raport me denarin.



Sipas analizës së lëvizjeve të indekseve të REDK-së të llogaritura me ponderim të bazuar në tregtinë e jashtme pa produkte primare, REDK-ja bazuar në shpenzimet e jetesës shënoi mbivlerësim prej 4,9% në bazë vjetore, ndërsa REDK bazuar në çmimet e prodhuesve të produkteve industriale u nënvlerësua me 0,5% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, në kushtet e rritjes së shpenzimeve relative të jetesës me 3,0% dhe çmime më të ulëta të prodhuesve të produkteve industriale me 2,3% në bazë vjetore. Në të njëjtën kohë, kursi efektiv nominal i këmbimit u vlerësua për 1,9%, që vjen si pasojë e mbivlerësimit të denarit në raport me lirën turke.


Përsa i përket konkurrueshmërisë së çmimeve për periudhën prill-maj 2023, REDK-ja e defluar nga shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e produkteve industriale shënuan mbivlerësim në bazë vjetore prej 6,0% përkatësisht 8,9%. Në të njëjtën kohë, NEDK-ja shënoi mbivlerësim prej 3,3% në bazë vjetore, që erdhi si pasojë e nënvlerësimit të lirës turke dhe rublës ruse ndaj denarit. Bazuar në përllogaritjen me ponderë të bazuara në tregtinë e jashtme pa produkte primare, indeksi REDK-ë i deflatuar me shpenzimet e jetesës shënoi mbivlerësim prej 3,8%, dhe REDK i deflatuar me çmimet e

prodhimit industrial shënoi mbivlerësim prej 5,7%. Në të njëjtën kohë, kursi efektiv nominal i këmbimit vlerësohet për 2,2%, që vjen si pasojë e mbivlerësimit të denarit në raport me lirën turke.



1.6.2. Llogaria financiare


Në tremujorin e parë të vitit 2023, llogaria financiare në bilancin e pagesave regjistroi hyrje neto prej 138,2 milionë euro, ose 1% e PBB-së. Në të njëjtën kohë, këto arritje në llogarinë financiare i detyrohen më së shumti hyrjeve neto në investimet e portofolit, si rezultat i huamarrjes së shtetit në tregun ndërkombëtar të kapitalit.⁴⁰ Flukse hyrëse në bazë neto janë regjistruar edhe nga investimet e huaja të drejtpërdrejta, të cilat rezultojnë nga flukset pozitive në komponentin joborxhi, respektivisht fitimi i riinvestuar dhe kapitali aksionar, me dalje të vogla neto në huamarrjen ndërsqerore. Nga ana tjetër, kategoritë e tjera të llogarisë financiare shënuan dalje neto në tremujorin e parë të vitit. Daljet neto më të larta në këtë periudhë u regjistruan në kredi, të ndikuar më së shumti nga lëvizjet në kreditë afatshkurtra të lidhura me zbatimin e aktiviteteve të administrimit të rezervës valutore nga banka qendrore. Dalje neto janë regjistruar edhe në valuta dhe depozita, që më së shumti vjen si pasojë e daljeve të larta neto në sektorët e tjerë (kryesisht sektori i popullsisë), si dhe në kategorinë “kredi dhe paradhënie tregtare”.




Analiza në bazë vjetore tregon për arritje më të mira të flukseve financiare në tremujorin e parë të vitit 2023, me flukse hyrëse neto të realizuara duke regjistruar rritje prej 0,9 p.p. të PBB-së krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të njëjtën kohë, kontributin më të madh në flukset hyrëse neto më të larta e kanë flukset hyrëse neto të realizuara në investimet e portofolit, si rezultat i huamarrjes së shtetit në tregun ndërkombëtar të kapitalit, në krahasim me daljet mbi bazë neto në të njëjtën periudhë

⁴⁰ Në mars të vitit 2023, Ministria e Financave emetoi eurobondin e nëntë në vlerën 500 milionë euro, me interes 6,96%.

të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, në kategorinë “kredi tregtare dhe paradhënie” ka pasur dalje neto në krahasim me hyrjet neto të realizuara në të njëjtën periudhë të një viti më parë, dhe dalje neto më të larta janë regjistruar në kredi (në tërësi për shkak të kredive afatshkurtra.), si dhe në valuta dhe depozita (dalje mbi bazë neto në institucionet depozituese kundrejt flukseve neto të larta në të njëjtën periudhë të një viti më parë). Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja të drejtpërdrejta janë afër realizimeve në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të tremujorit të parë 2023 është 4.159,2 milionë euro, që paraqet rritje prej 296,3 milionë euro krahasuar me tremujorin paraardhës. E analizuar nëpërmjet faktorëve të ndryshimit, rritja e rezervave valutore në tërësinë e saj rrjedh nga transaksionet për llogari të shtetit, respektivisht nga flukset hyrëse nga eurobondi i sapoemeluar.




Në fund të tremujorit të dytë 2023, bilanci i rezervave valutore bruto arrin në 4.189,7 milionë euro, që paraqet rritje prej 30,6 milionë euro krahasuar me tremujorin paraardhës. E analizuar përmes faktorëve të ndryshimit, rritja e rezervave valutore në këtë periudhë rezulton tërësisht nga operacionet e Bankës Popullore lidhur me menaxhimin e rezervave valutore.

1.6.3. Pozicioni investues ndërkombëtar dhe borxhi i jashtëm bruto



Në fund të tremujorit të parë të vitit 2023, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë maqedonase arrin në 8.100,9 milionë euro, ose 57,1% e PBB-së⁴¹. Krahasuar me situatën në

⁴¹ Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (që nga prilli i vitit 2023).

fund të tremujorit paraardhës, pozicioni neto i borxhit shënoi ngushtim prej 6,1 p.p. të PBB-së, në kushtet e reduktimit më të madh të detyrimeve ndërkombëtare në raport me rënien e fondeve ndërkombëtare. Nga analiza sektoriale rezultoi se përmirësimi i pozicionit neto të borxhit rezultoi kryesisht nga pakësimi i detyrimeve neto të sektorëve të tjerë (kryesisht në bazë të investimeve të drejtpërdrejta, kredive afatgjata dhe kredive tregtare). Zvogëlimi i detyrimeve neto është vërejtur edhe tek institucionet depozituese, ndërsa në të njëjtën kohë janë rritur aktivet neto në bankën qendrore. Nga ana tjetër, ka pasur rritje të detyrimeve neto të sektorit "shtetëror" si pasojë e huamarrjes në tregun ndërkombëtar nëpërmjet emitimit të letrave me vlerë të borxhit⁴².



Në bazë vjetore, vërehet ngushtim i pozicionit negativ të investimeve ndërkombëtare me 2,7 p.p. nga PBB-ja⁴³, nën ndikimin e rritjes së fondeve ndërkombëtare, ndërsa në të njëjtën kohë, rënie të lehtë të detyrimeve ndërkombëtare (për 2,4 p.p., respektivisht 0,3 p.p. nga PBB-ja⁴⁴). Përmirësimi i pozicionit të investimeve ndërkombëtare vjen si pasojë e rritjes së aktiveve neto të bankës qendrore, kryesisht si pasojë e rritjes së rezervave valutore. Gjithashtu, në këtë drejtim kanë ndikuar edhe ulja e detyrimeve neto të sektorëve të tjerë (kryesisht në bazë të investimeve të drejtpërdrejta) dhe institucioneve depozituese (në bazë të valutave dhe depozitave). Nga ana tjetër, rritja e detyrimeve neto të shtetit ndikoi në zgjerimin e pozicionit të borxhit neto në tremujorin e parë të vitit 2023.




Në fund të tremujorit të parë të vitit 2023, niveli i borxhit të jashtëm bruto arrin në 11.079,8 milionë euro, ose 78,1% e PBB-së, që përfaqëson rënie prej 6,1 p.p. të PBB-së, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Duke përjashtuar efektin e aktiviteteve specifike për menaxhimin e

⁴² Në mars të vitit 2023, Ministria e Financave emetoi eurobondin e nëntë në vlerën 500 milionë euro, me interes 6,96% dhe afat shlyerje 4 vjet.


⁴³ Në terma absolutë, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë maqedonase në tremujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 384,6 milionë euro.

⁴⁴ Në terma absolutë, në tremujorin e parë të vitit 2023, aktivet ndërkombëtare dhe obligacionet shënuan rritje vjetore prej 1.044,3, përkatësisht 1.428,9..

rezervave valutore të Bankës Popullore⁴⁵, borxhi i jashtëm bruto është 76,5% e PBB-së dhe ka shënuar rënie tremujore prej 4,3 p.p. e PBB-së⁴⁶, me ulje më të madhe të borxhit privat krahasuar me rënien e borxhit publik (për 3,7 p.p., përkatësisht 0,5 p.p. të PBB-së). Pozicioni më i mirë i borxhit të sektorit privat vjen si pasojë e uljes së detyrimeve në bazë të kredive tregtare dhe paradhënieve dhe kredive për sektorin jobankar, si dhe uljes së detyrimeve afatshkurtra në valuta dhe depozitat bankare. Ulje të detyrimeve janë vërejtur edhe tek subjektet e ndërlidhura, gjë që ndikon në drejtim të uljes së borxhit të jashtëm bazuar në investimet e drejtpërdrejta. Treguesit relativë tregojnë gjithashtu borxh publik më të ulët, nën ndikimin e uljes së detyrimeve afatgjata në bazë të kredisë për ndërmarrjet publike, në krahasim me rritjen e borxhit të qeverisë qendrore për shkak të emetimit të eurobondit të ri.



Borxhi i jashtëm bruto shënoi rënie të vogël vjetore për 0,3 p.p. të PBB-së⁴⁷, në kushtet e reduktimit më të lartë të borxhit privat në krahasim me rritjen e borxhit publik (për 1,7 p.p. respektivisht 1,4 p.p. të PBB-së). Detyrimet më të ulëta afatshkurtra në valuta dhe depozitat bankare private janë faktori kryesor i rënies vjetore të borxhit privat në tremujorin e parë të vitit 2023, ndërkohë që ndryshimi i borxhit publik vjen si pasojë e rritjes së borxhit të qeverisë qendrore.




Më 31.3.2023, borxhi i jashtëm neto arrin në 4.073,2 milionë euro, ose 28,7% të PBB-së, që paraqet rënie tremujore prej 2.7 p.p. nga PBB-ja⁴⁸, e nxitur nga rënia e borxhit neto privat, ndërkohë që niveli i borxhit neto publik ka mbetur i pandryshuar.

⁴⁵ Veprimtaritë specifike për administrimin e rezervave valutore të bankës qendrore i referohen marrëveshjeve repo dhe operacioneve të tjera që lidhen me administrimin e rezervave valutore.

⁴⁶ Në terma absolutë, borxhi i jashtëm bruto në tremujorin e tretë të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 267,5 milionë euro, në kushtet e rritjes nominale si të borxhit publik ashtu edhe të borxhit privat (401,8, përkatësisht 34,3 milionë euro).

⁴⁷ Në terma absolutë, borxhi i jashtëm bruto në tremujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 945,6 milionë euro, në kushtet e rritjes nominale si të borxhit publik ashtu edhe të borxhit privat (652,3, përkatësisht 293,3 milionë euro).

⁴⁸ Në terma absolutë, borxhi i jashtëm neto në tremujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje të vogël tremujore prej 24,7 milionë euro.



Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së brendshme vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt. Treguesi i pjesëmarrjes së borxhit të jashtëm bruto në PBB-në vazhdon ta klasifikojë ekonominë në grupin e vendeve me borxhe të larta, ndërkohë që të gjithë treguesit e tjerë të aftësisë paguese dhe të likuiditetit tregojnë për borxh të ulët. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë strukturore e detyrimeve bazuar në investimet e drejtpërdrejta si formë e financimit të shoqërive me kapital të huaj, si dhe kreditë tregtare si instrument financimi në tregtinë ndërkombëtare, në borxhin e jashtëm bruto, e zbut profilin e rrezikut në lidhje me pozicionin e borxhit të ekonomisë. Niveli i borxhit të jashtëm bruto, pa përfshirë kreditë tregtare dhe borxhin ndërkombëtar, është më i ulët dhe arrin në 47,2% të PBB-së⁴⁹, që është tregues i borxhit të moderuar.

Treguesi i borxhit të jashtëm	Aftësia paguese				Likuiditeti		
	Shlyerja e interesit/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Borxhi bruto/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Borxhi bruto/ PBB	Shlyerja e interesit/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Rezerva valutore/ borxh afatshkurtër	Rezerva valutore/ borxh afatshkurtër, me maturim të mbetur**	Borxhi afatshkurtër/ Borxhi total
	në %				raport	raport	në %
31.12.2010	3.2	140.4	59.7	13.9	1.5	1.0	27.9
31.12.2011	3.1	148.4	64.6	16.8	1.8	1.2	25.2
31.12.2012	2.9	142.1	67.6	13.1	1.6	1.0	26.7
31.12.2013	2.5	137.3	67.3	15.8	1.6	1.1	23.3
31.12.2014	3.0	149.1	74.0	17.2	1.8	1.1	22.3
31.12.2015	2.7	143.9	73.2	20.0	1.7	1.1	21.3
31.12.2016	2.4	148.8	79.3	14.8	1.7	1.2	21.9
31.12.2017	2.7	138.6	76.9	12.7	1.3	0.9	23.9
31.12.2018	2.2	130.7	77.3	15.7	1.4	1.0	25.8
31.03.2019	2.0	123.1	74.3	9.0	1.4	1.0	26.0
30.06.2019	2.0	124.4	75.5	9.0	1.4	1.0	26.5
30.09.2019	2.0	128.0	77.3	9.0	1.4	1.0	27.8
31.12.2019	2.0	121.9	76.3	9.0	1.6	1.0	25.6
31.03.2020	1.9	118.9	73.8	13.6	1.4	1.0	26.6
30.06.2020	1.9	125.7	79.4	13.6	1.9	1.2	22.4
30.09.2020	1.9	129.9	80.7	13.6	1.7	1.0	22.9
31.12.2020	1.9	122.3	77.9	13.6	1.9	1.1	20.4
31.03.2021	2.2	127.6	84.3	16.3	1.9	1.2	21.5
30.06.2021	2.2	130.2	86.0	16.3	1.9	1.2	22.0
30.09.2021	2.2	125.9	83.1	16.3	1.8	1.3	22.2
31.12.2021	2.2	126.9	83.8	16.3	1.8	1.3	21.5
31.03.2022	1.8	118.2	83.8	9.2	1.3	0.9	26.0
30.06.2022	1.8	117.6	83.4	9.2	1.2	0.9	26.3
30.09.2022	1.8	124.0	87.9	9.2	1.3	0.9	26.8
31.12.2022	1.8	124.3	88.1	9.2	1.5	1.0	25.0
31.03.2023	2.7	112.0	83.9	15.2	1.6	1.0	23.6
Kritere për debitim të moderuar*	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1.00		

*Kriteri për debitim të moderuar është marrë sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përgaditjen e treguesve të debitimit, e cila nënkupton përdorimin e mesatareve lëvizëse trevjeçare të PBB-së dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera, si emërues në llogaritjen e treguesve.

E përgaditur në pajtim me "External debt statistics: Guide for compilers and users", i emetuar nga FMN-ja.

**Sipas rregullës së Grinspan dhe Guidoti, e nevojshme është që vendi ta ruaj mbulimin e tërë të borxhit afatshkurtër (maturim i mbetur) me rezerva valutore. Borxhi afatshkurtër sipas maturimit të mbetur llogaritet duke shtuar shumën e borxhit të jashtëm (maturimin origjinal), i cili duhet të paguhet në periudhë prej një viti ose më pak, në borxhin e jashtëm afatshkurtër (maturimin origjinal).

Burimi: BPRMV-ja.



⁴⁹ I referohet borxhit, pa marrëveshje repo.

II. Politika monetare⁵⁰



Banka Popullore vazhdoi shtrëngimin e politikës monetare edhe në tremujorin e dytë të vitit 2023, e cila filloi në fund të vitit 2021. Kështu, gjatë tremujorit të dytë, norma e interesit për bonot e thesarit u rrit dy herë, në total prej 0,50 p.p. në nivelin prej 6,00%. Gjatë vendimmarrjes, janë marrë parasysh të dhënat dhe informacionet më të fundit për ekonominë vendase dhe botërore dhe zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe vendase, në kuadër të përcaktimit të politikës monetare, gjatë të cilës vazhdojnë të jetë në fokus lëvizjet e çmimeve. Konkretisht, megjithëse norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohej gjatë tremujorit të dytë, dhe pritshmëritë inflacioniste u qetësuan gradualisht, megjithatë, ato vazhdojnë të jenë në nivel relativisht më të lartë, prandaj është e nevojshme të veprohet për stabilizimin e tyre në bazë më të qëndrueshme. Gjithashtu, duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit të qëndrueshëm të këmbimit të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare të brendshme pasojnë ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane, të cilat gjithashtu ishin në drejtim të shtrëngimit të mëtejshëm. Rezervat valutore në tremujorin e dytë 2023 janë në nivel të përshtatshëm dhe në zonë të sigurt dhe baza e depozitave të bankave shënon normë solide rritjeje vjetore. Rreziqet në ekonominë globale dhe vendase vazhdojnë të evidentohen dhe Banka Popullore do të vazhdojë t'i mbikëqyr nga afër dhe, nëse është e nevojshme, do të veprojë duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, për të ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit dhe të çmimit afatmesëm.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, norma bazë e interesit – norma e interesit në bonot e thesarit të Bankës Popullore, u rrit dy herë në totalin e 0,50 p.p., që arriti në 6,0%. Ndryshimet në përcaktimin e politikës monetare janë ende të nxitura nga inflacioni dhe pritshmëritë inflacioniste. Njëkohësisht, ndryshimet në normën bazë të interesit u plotësuan me rritjen e normave të interesit për depozitat njëditore dhe shtatëditore në të njëjtën masë, në nivelet 3,90%, përkatësisht 3,95%. Shuma e ofruar e bonove të thesarit mbeti e pandryshuar në 10.000 milionë denarë, dhe vazhdoi zbatimi i ndryshimeve në instrumentin e rezervës së detyrueshme, përmes të cilit nxitet kreditimi i projekteve që kanë të bëjnë me prodhimin vendor të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Gjithashtu, për të forcuar më tej rezistenën e sektorit bankar, Banka Popullore miratoi masë makroprudenciale për rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave vendase me 0,25 pikë përqindje, nga 0,75% e përcaktuar më parë në 1%, me fillimin e zbatimit nga 1 korriku 2024. Kjo masë synon të veprojë në mënyrë parandaluese dhe të çojë në forcimin e mëtejshëm të pozicionit kapital të bankave, duke marrë parasysh kushtet aktuale makroekonomike dhe lëvizjet e tregut të pasurive të paluajtshme. Kjo masë është në pajtim me masat e marra në numër më të madh të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat kërkojnë mjaftueshmëri më të madhe të kapitalit të bankave si mbrojtje ndaj rreziqeve të mundshme mjedisore.

⁵⁰ Informacion më të detajuar për masat e reja monetare mund të lexoni në faqen e internetit të Bankës Popullore: https://www.nbrm.mk/content/MPI%20publikacii/Hronologija_na_promenite_vo_postavenosta_na_monetarnite_instrumenti_na_Narodnata%20banka.pdf




Realizimet⁵¹ e treguesit bazë makroekonomik në ekonominë e brendshme janë kryesisht brenda pritshmërive sipas ciklit të fundit të projeksioneve. Rritja reale e PBB-së u përshpejtua në tremujorin e parë të vitit, duke arritur në 2,1% në bazë vjetore. Të dhënat me frekuencë të lartë të disponueshme për tremujorin e dytë janë të pamjaftueshme për të kuptuar situatën në tërësi, por të dhënat tregojnë për lëvizje më të moderuara në krahasim me tremujorin e mëparshëm. Në pajtim me pritshmëritë, norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohej dhe në periudhën prill-maj 2023 zbriti në mesataren prej 12,1%. Gjatë tremujorit të dytë, rezervat valutore shënuan rritje dhe u ruajtën në zonën e sigurt, në nivel që plotëson kërkesat për mjaftueshmëri sipas standardeve ndërkombëtare. Lëvizjet në tregun valutor vendas janë ende të qëndrueshme, ndërkohë që Banka Popullore ka qenë e pranishme vetëm herë pas here në tregun valutor. Lëvizjet në gjithsej depozitat dhe gjithsej kreditë në muajin maj janë në pajtim me parashikimet e fundit për rritje të përshpejtuar të depozitave dhe rritje më të moderuar të kredive në tremujorin e dytë të vitit.



Në tremujorin e dytë të vitit 2023, BQE-ja rriti normën bazë të interesit për 0,5 p.p. dhe arriti nivelin prej 4,0%. Kështu, diferenca ndërmjet normës bazë të interesit të Bankës Popullore dhe normës bazë të interesit të BQE-së në fund të qershorit 2023 ishte 2,0 p.p. dhe ka mbetur i pandryshuar në krahasim me tremujorin paraprak. Lidhur me normat treguese të interesit të tregut prej 1 m EURIBOR dhe 1 m SKIBOR, diferenca ndërmjet tyre u ul për 0,27 p.p. në fund të tremujorit të dytë 2023, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.


⁵¹ I referohet informacionit të disponueshëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, i cili është marrë parasysh gjatë marrjes së vendimeve për përcaktimin monetar në atë periudhë.

Në ekonominë vendase, sa i përket normave të interesit në numrit të përgjithshëm të depozitave (në denarë dhe në valutë të huaj) në maj 2023, normat e interesit për depozitat në denarë dhe në valutë janë më të larta për 0,1 p.p. në raport me fundin e muajit mars 2023, ato janë 1,6%, përkatësisht 0,9%. Në të njëjtën kohë, diferenca e interesit ka mbetur e pandryshuar në krahasim me fundin e tremujorit të mëparshëm dhe ka arritur vlerën 0,7 p.p.. Te depozitat e përgjithshme të sapo pranuar⁵², diferenca e interesit në muajin maj u ul në krahasim me fundin e tremujorit paraardhës dhe arriti në 0,7 p.p., e ndikuar nga normat më të ulëta të interesit në denarë, me norma të pandryshuara të interesit valutor, krahasuar me mars 2023.



2.1. Likuiditeti bankar

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, likuiditeti në denarë i bankave shënoi rënie të lehtë. Duke qenë se ndryshimi i faktorëve autonom ka vepruar në drejtim të krijimit të likuiditetit, ulja e likuiditetit të bankave në tërësinë e tij rezulton nga ndryshimi i instrumenteve monetare.




Faktorët autonome në bazë neto në tremujorin e dytë të vitit 2023 kontribuan në krijimin e likuiditetit në sistemin bankar për 8.714 milionë denarë. Ky ndryshim është tërësisht rezultat i transaksioneve të shtetit, ndërsa në tërheqjen e likuiditetit kanë ndikuar paratë e gatshme në qarkullim dhe ndërhyrjet valutore të Bankës Popullore.

⁵² Për sa i përket normave të interesit të kredive të sapo miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e miratuara rishtazi rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

Nga këndvështrimi i ndryshimit të instrumenteve monetare, investimet e bankave në depozita të disponueshme (njëditore dhe shtatëditore) janë rritur për gjithsej 14.728 milionë denarë dhe kanë tërhequr likuiditetin nga sistemi bankar. Në të njëjtën kohë, depozitat 7 ditore në tremujorin e dytë u rritën për 7.928 milionë denarë, ndërsa ato njëditore për 6.800 milionë denarë. Në fund të tremujorit të dytë, teprica e instrumentit bazë - bonot e thesarit të BPRMV-së arriti në 8,334 milionë denarë dhe ishte më e ulët për 1.666 milionë denarë, krahasuar me fundin e tremujorit paraprak.

Instrumenti i depozitave në valutë në Bankën Popullore u prezantua në gjysmën e dytë të vitit 2020, në periudhën e pandemisë së shkaktuar nga covid-19. Në maj të vitit 2023, ai u ndërpre, në pajtueshmëri me rrethanat e ndryshuara dhe interesin e reduktuar të bankave, në mënyrë që gjendja e këtij instrumenti gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023 u ul me 9,5 milionë euro dhe u zvogëluar në zero.



Në tremujorin e dytë të vitit 2023, bankat në llogaritë e tyre në Bankën Popullore vazhduan të kenë më shumë mjete të veçuara se shuma e përcaktuar e rezervës së detyrueshme në denarë, mesatarisht për rreth 2,3%.



III. Lëvizjet e tregjeve financiare

Norma e interesit në tregun e depozitave ndërbankare në tremujorin e dytë të vitit 2023 u rrit në bazë tremujore me 0,7 p.p. dhe mesatarisht 3,5%, në kushtet e rritjes së normës bazë të interesit të Bankës Popullore. Gjithashtu, të gjitha kuotimet mesatare të SKIBOR-it shënuan lëvizje në rritje. Në tregun primar të letrave shtetërore me vlerë, emetimet e reja ishin kryesisht me maturime më të gjata, ndërsa në tregun sekondar të letrave me vlerë tregtoheshin vetëm transaksione repo, por në sasi të vogël. Në Bursën e Maqedonisë, qarkullimi i aksioneve është rritur për 27,5% në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa vlera e MBI-10 ka shënuar rënie tremujore prej 2,2%. Në bursat rajonale, indekset shënuan rritje të moderuar, mesatarisht 5,1% në bazë tremujore. Në tregjet financiare ndërkombëtare, indekset e luhatshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, respektivisht indekset MOVE dhe VIX shënuan sërish ndryshim në rënie, gjë që tregon ulje të pasigurisë dhe luhatshmërisë së tregjeve. Diferencat ndërmjet normës së kthimit të eurobonove maqedonase dhe gjermane u ngushtuan në krahasim me tremujorin paraardhës, me rritje të moderuar të normës së kthimit

të obligacioneve shtetërore gjermane dhe rënie të normës së kthimit të eurobonove maqedonase.

3.1. Tregu ndërbankar i depozitave të pasiguruar


Në tremujorin e dytë të vitit 2023, norma mesatare e interesit në tregun e depozitave ndërbankare (MKBS) u rrit për 0,7 p.p. krahasuar me tremujorin paraardhës dhe arriti në 3,5%, në kushtet e rritjes së normës bazë të interesit të Bankës Popullore për 0,5 p.p.. Tregtimi në tregun e depozitave ndërbankare shënoi rënie në tremujorin e parë dhe arriti në 515 milionë denarë (691 milionë denarë në tremujorin paraprak), në pjesën më të madhe si rezultat i zvogëlimit të transaksioneve me afat maturimi deri në shtatë ditë dhe deri në një muaj, ndërkohë që transaksionet njëditore shënojnë rritje të lehtë. Në baza tremujore, të gjitha kuotimet mesatare të SKIBOR-it shënuan zhvendosje në rritje deri në 0,5 p.p.




3.2. Tregu i letrave shtetërore me vlerë

Gjendja e letrave me vlerë të emtuara shtetërore në tregun primar në tremujorin e dytë të vitit 2023 shënoi rritje për 5.086 milionë denarë ose 3,1% në bazë tremujore dhe arriti në 170.041 milionë denarë. Analizuar nga aspekti i strukturës së letrave me vlerë shtetërore, obligacionet shtetërore janë ende kategoria dominuese në gjendjen e gjithsej letrave me vlerë shtetërore të emtuara në tregun primar, me pjesëmarrje prej 77,6%. Gjithashtu, obligacionet shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në strukturën termike të letrave shtetërore me vlerë me 44,9% (43,9% në tremujorin paraprak) e cila është në pajtim me udhëzimet e strategjisë fiskale të Ministrisë së Financave për emetimin e obligacioneve shtetërore me afat më të gjatë maturimi, me qëllim optimizimin e pagesave të borxhit dhe uljen e rrezikut të rifinancimit.⁵³ Në rastin e letrave të tjera shtetërore, të analizuar nga aspekti i maturimit, vërehet rënie e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha, me përjashtim të bonove dymbëdhjetëmujore shtetërore, të cilat mbetën të qëndrueshme, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Nga këndvështrimi i strukturës valutore, letrat shtetërore me vlerë në valutë vendase pa klauzolë valutore vazhduan të ruajnë pjesëmarrjen e tyre dominuese, duke përbërë 66,9% të totalit të letrave shtetërore me vlerë (66,5% në tremujorin e kaluar). Për sa i përket strukturës së pronësisë, në këtë tremujor bankat kanë ulur lehtësisht pjesëmarrjen e tyre nga 34,9% në 34,3%, në kurriz të rritjes së pjesëmarrjes së investitorëve të tjerë (65,7%). Ndër investitorët e tjerë, fondet pensionale vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (me pjesëmarrje prej 46,5%).


⁵³ Strategjia Fiskale e Rishikuar 2024 - 2028, Ministria e Financave, maj 2023.

**Letrat shtetërore me vlerë**
bilancet, në mil. denarë

Burimi: Ministria e Financave.

Struktura me afat e LShV-ve
bilancet, në mil. denarë

Burimi: Ministria e Financave.


Struktura pronësisë e LShV-ve
bilancet, në mil. denarë

Burimi: Ministria e Financave.



Struktura valutore e LShV-ve
bilancet, në mil. denarë

Burimi: Ministria e Financave.


Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, normat e interesit të letrave shtetërore me vlerë, të përcaktuara nga Ministria e Financave, shënuan ndryshime në rritje. Kështu, bonot dymbëdhjetëmujore shtetërore pa klauzolë valutore u emetuan në tregun primar me normë mesatare të ponderuar interesi prej 4,0% (3,8% në tremujorin paraardhës). Obligacionet shtetërore 15 vjeçare pa dhe me klauzolë valutore janë emetuar gjithashtu gjatë tremujorit me norma mesatare të ponderuara interesi 5,9%, përkatësisht 5,65% (5,7%, përkatësisht 5,65% në tremujorin paraprak).

Normat e interesit të tregut primar
LShV pa klauzolë valutore

Burimi: Ministria e Financave.


Kurba e normave të kthimit të LShV-ve pa klauzolë valutore (në %)**LShV me klauzolë valutore**
mesatarja për periudhën, në %

Burimi: Ministria e Financave.


Kurba e normave të kthimit të LShV-ve me klauzolë valutore (në %)

Tregtimi i letrave me vlerë në tregun sekondar, në tremujorin e dytë të vitit 2023 ishte i ulët dhe arriti në 69 milionë denarë (135 milionë denarë në tremujorin paraprak), ndërsa në këtë segment të

tregut janë realizuar vetëm repo transaksione me letra shtetërore me vlerë me afat deri në një muaj (me normë interesi repo prej 3,5%). Këto ndryshime tregojnë për rënie të tregtimit në tregun sekondar të letrave me vlerë, të ndjekur nga koeficienti i likuiditetit⁵⁴.



Në tregjet financiare në eurozonë dhe në ShBA në tremujorin e dytë të vitit 2023, norma e kthimit e letrave me vlerë shtetërore 10 vjeçare⁵⁵ u mbajtën në nivelin e tremujorit të mëparshëm dhe mesatarisht rreth 2,6% dhe 3,6%, respektivisht, në kushtet e rritjes më të moderuar të normave të interesit nga FED-i dhe BQE-ja dhe trysnive të reduktuara inflacioniste.




Normat e kthimit të eurobonove maqedonase⁵⁶ në tremujorin e dytë të vitit 2023, mesatarisht, ato shënuan rënie, ndërsa në të njëjtën kohë zhvendosje të moderuar në rritje të normave të interesit të obligacioneve të shtetërore gjermane. Kjo çoi në ngushtim të mëtejshëm të shpërndarjeve të cilat në mesatare arritën në 1,2 p.p., 3,1 p.p., 3,6 p.p., 3,9 p.p., respektivisht 4,1 p.p.

⁵⁴Koeficienti i likuiditetit të tregut sekondar paraqet raportin mes qarkullimit mesatar ditor dhe gjendjes së letrave me vlerë.


⁵⁵Për eurozonën, këto janë obligacione të përgjithshme shtetërore që rrjedhin nga lakorja e normës së kthimit të obligacioneve shtetërore të Francës dhe Gjermanisë, ndërsa për ShBA-të norma të kthimit që rrjedhin nga lakorja e normës së kthimit të obligacioneve shtetërore amerikane.

⁵⁶ Bëhet fjalë për eurobondet maqedonase të emetuara në korrik 2016, janar 2018, qershor 2020 dhe mars 2021. Eurobondet u emetuan në shumë nominale 450 milionë euro, përkatësisht 500 milionë euro, 700 milionë euro dhe 700 milionë euro, me maturim 7, 7, 6 dhe 7 vjet dhe norma vjetore interesi prej 5,625%, 2,75 %, 3,675%, përkatësisht 1,625%.



3.3. Bursat

Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2023, vlera e indeksit të bursës maqedonase për aksionet MBI-10 u ul me 2,2% (rritje prej 3,4% në tremujorin paraardhës) dhe arriti në 5.713 pikë indeksi. Qarkullimi i përgjithshëm i bursës shënoi rritje tremujore prej 27,5% (pas një rënie prej 58,8% në tremujorin e fundit), si rezultat i rritjes së qarkullimit të aksioneve dhe obligacioneve. Vlera e indeksit të obligacioneve (OMB) gjatë tremujorit u ul me 1 pikë indeksi dhe arrin në 127 pikë indeksi.





Në tremujorin e dytë të vitit 2023, indekset e bursave të rajonit shënuan rritje të moderuar tremujore, e cila ishte mesatarisht 5,1% (rritje nga 4,5% në tremujorin e mëparshëm). Rritja është kryesisht për shkak të rritjes së indekseve hungareze dhe polake. Gjithashtu, indekset e luhatshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, respektivisht indekset MOVE dhe VIKS⁵⁷ në baza ditore, vërejtën ndryshim në rënie, respektivisht indeksi MOVE u ul mesatarisht me 0,5% mesatarisht (pas rënies prej 6,7% në tremujorin paraardhës), ndërsa indeksi VIX u ul mesatarisht me 19,6% (pas uljes prej 18,2

⁵⁷Indeksi MOVE (Merrill Lynch Option Volatility Estimate) e tregon ndryshueshmërinë e prejardhjes (ose të nënkuptuar) së tregjeve amerikane të letrave shtetërore me vlerë. Indeksi VIKS (Volatility Index) është ndërtuar në bazë të prejardhjes së ndryshueshmërisë së opsioneve të indeksit S&P 500. Investitorët i përdorin të dy indekset si tregues të kushteve dhe pritshmërive në lidhje me paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare. Rënia e indekseve tregon rënie të ndryshueshmërisë



% në tremujorin e mëparshëm). Lëvizjet e dy indekseve, të parë së bashku, tregojnë ulje të moderuar të pasigurisë dhe luhatshmërisë në tregjet globale të kapitalit.



IV. Agregatët monetarë dhe kreditorë



Pas rënies së zakonshme sezonale në tremujorin e parë të vitit, në tremujorin e dytë agregati monetar më i gjerë M4 shënoi rritje më të theksuar tremujore si rezultat i të gjitha nënkategorive. Kontributin më të madh në rritje e kanë dhënë para depozituese (në pjesën më të madhe të vëllimit në sektorin e ndërmarrjeve) dhe depozitat afatgjata, të cilat rriten vazhdimisht për të katërtin tremujor radhazi. Në tremujorin e dytë vihet re rritje e kredisë në të dy sektorët, pas stagnimit në tremujorin e mëparshëm, ndërkohë që në bazë vjetore aktiviteti kreditor vijon të ngadalësohet. Rezultatet e fitura nga Anketa e Aktivitetit Kreditor (AKA) në tremujorin e dytë të vitit 2023, shfaqin shtrëngim të mëtejshëm neto të kushteve të përgjithshme të kredisë, me intensitet të ngjashëm midis ndërmarrjeve dhe me intensitet më të moderuar tek amvisëritë krahasuar me anketën e tremujorit paraardhës. Nga pikëpamja e kërkesës për kredi, ajo tregon rritje të lehtë neto për ndërmarrjet, në krahasim me rënie neto nga anketa e mëparshme, ndërsa në rastin e amvisërive, bankat ende tregojnë rënie të ndjeshme neto të kërkesës.

4.1. Agregatët monetarë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, oferta më e gjerë monetare M4 shënoi rritje tremujore më të ndjeshme prej 4,6%. Nga pikëpamja strukturore, rritja rezulton nga rritja e të gjithë përbërësve të ofertës monetare, me rritjen më të madhe të parasë depozituese, si përbërësi më likuid i ofertës monetare (me kontribut pozitiv prej 2,3 p.p.), më pas në depozitat afatgjata (kontributi pozitiv prej 1,5 p.p.), me rritje më të ulët të parave të gatshme në qarkullim dhe depozitat afatshkurtra (me kontribut për 0,4 p.p.). Në lidhje me **strukturën valutore**, vazhdojnë lëvizjet pozitive në depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozitave), të cilat shënojnë rritje tremujore, ndërsa rriten edhe depozitat në valutë (me kontribut pothuajse të njëjtë në rritjen). Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e depozitave në valutë në M4 në fund të tremujorit të dytë është 39,6%, e cila është me 0,9 p.p. më i ulët krahasuar me fundin e tremujorit të mëparshëm. Në bazë vjetore, rritja e agregatit monetar M4 vazhdon të përshpejtohet dhe në fund të tremujorit të dytë 2023 arriti në 11,4% (6,9% në fund të tremujorit paraardhës).

Masa monetare M4, struktura

(ndryshime tremujore, kontribute në pikë përqindje)




Burimi: BPRMV-ja.

Totali i depozitave në sistemin financiar⁵⁸, në tremujorin e dytë të vitit 2023 u shënua rritje prej 4,6% në bazë tremujore (kundrejt rënies tremujore prej 1,0% në tremujorin e mëparshëm). Nga **aspekti sektorial**, rritje e depozitave është vërejtur në të gjithë sektorët, nga të cilët rritje më të madhe ka në depozitat e ndërmarrjeve (kontribut prej 2,5 p.p.) dhe te depozitat e amvisërive (kontribut prej 1,7 p.p.), ndërsa rritja në sektorët e tjerë është më e moderuar (kontribut prej 0,4 p.p.). Vazhdojnë tendencat e favorshme në strukturën valutore dhe të maturimit të depozitave. Nga **aspekti valutor**, vazhdon rritja e depozitave në denarë (përfshirë paratë depozituese), e cila është më e lartë se rritja e depozitave në valutë (me kontribut 3,6 p.p., përkatësisht 1,0 p.p.). Për sa i përket **maturitetit**, rritje më e madhe vërehet te depozitat afatgjata në raport me rritjen e depozitave afatshkurtra (1,7 p.p., përkatësisht 0,4 p.p.), të cilat kanë shënuar rritje të vazhdueshme për të katërtin tremujor radhazi. Në **bazë vjetore**, rritja e totalit të depozitave arriti në 11,6% (rritje prej 6,9% në fund të tremujorit paraardhës).


⁵⁸ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetor në bankat dhe kursimoret, mjetet e institucioneve tjera financiare të llogarive të BPRMV-ja dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes lokale të llogarive të BPRMV-ja. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjinden në lidhjen në vijim: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nsp.x.

**Depozita totale**

(kontribute në ndryshimin tremujor, në pikë përqindje)



(ndryshime vjetore, kontribute në p.p.)

**Depozita në total**

	2021				2022				2023	
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2
ndryshime tremujore, në %										
Depozita në total	1.1	1.8	1.3	3.0	-2.9	0.2	3.0	4.7	-1.0	4.6
kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të depozitave, në p.p.										
Para të depozituara	0.5	1.2	0.5	1.5	-2.8	0.7	1.9	2.5	-1.3	2.5
Depozita në denarë	-0.2	-0.7	-0.6	-1.2	-1.0	-0.9	0.3	0.7	0.3	1.0
Depozita në valuta të huaja	0.8	1.3	1.4	2.8	0.9	0.3	0.9	1.5	0.0	1.0
Depozita afatshkurtër	0.7	0.9	1.2	1.9	0.6	0.3	0.7	1.2	-0.2	0.4
Depozita afatgjata	-0.1	-0.3	-0.4	-0.4	-0.7	-0.9	0.4	1.0	0.5	1.7
Amvisëri	1.1	0.5	1.2	1.7	-0.9	1.4	1.2	2.0	0.7	1.7
Ndërmarrje	-0.3	1.5	0.2	1.6	-2.2	-0.9	1.7	2.5	-1.7	2.5
Sektorë të tjerë	0.3	-0.2	-0.1	-0.3	0.2	-0.3	0.1	0.1	-0.1	0.4

Burimi: BPRMV-ja.

Rritja e **depozitave të amvisërive** u përshpejtua në tremujorin e dytë të vitit (norma tremujore prej 2,6% krahasuar me rritjen e moderuar prej 1,0% në tremujorin e parë). Nga **aspekti valutor**, rritja më së shumti është si rrjedhojë e rritjes së depozitave në denarë (përfshirë paratë depozituese), me rritje më të ulët të depozitave në valutë. Për sa i përket **maturitetit**, depozitat afatgjata shënuan rritje të ndjeshme tremujore, si rezultat i stabilizimit gradual të pritjeve dhe i normës së kthimit më stimuluese të interesit, ndërkohë që depozitat afatshkurtra shënuan rënie. Në **bazë vjetore**, rritja e numrit të përgjithshëm të depozitave të amvisërive në tremujorin e dytë të vitit 2023 arriti në 8,8% (8,4% në fund të tremujorit paraardhës).

Depozitat e ndërmarrjeve në tremujorin e dytë të vitit 2023, shënuan rritje të ndjeshme prej 9,4%⁵⁹ (kundrejt rënies prej 5,8% në tremujorin paraprak). Nga aspekti i **strukturës valutore**, rritje vërehet si te depozitat në denarë (përfshirë paratë depozituese) ashtu edhe te depozitat në valutë. Nga **aspekti i maturitetit**, rritja është më e theksuar te depozitat afatshkurtra, e ndjekur nga rritja e depozitave afatgjata. Në **bazë vjetore**, depozitat e ndërmarrjeve në fund të tremujorit të dytë 2023 janë më të larta për 20,1% (nga 5,9% në fund të tremujorit të parë).

	Depozita të amvisërive				2022				2023	
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2
ndryshime tremujore, në %										
Totali i depozitave të amvisërive	1.7	0.8	1.8	2.6	-1.4	2.1	1.9	3.1	1.0	2.6
kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të depozitave, në p.p.										
Para të depozituara	0.6	0.5	0.9	0.5	-1.8	1.1	0.7	2.5	-0.2	1.2
Depozita në denarë	0.1	-0.6	-0.4	-1.3	-1.4	-0.8	0.0	0.7	0.5	0.9
Depozita në valuta të huaja	1.0	0.9	1.3	3.3	1.8	1.8	1.2	-0.1	0.8	0.4
Depozita afatshkurtër	1.1	1.0	1.3	2.3	0.9	1.3	0.7	-0.6	0.1	-0.5
Depozita afatgjata	-0.1	-0.7	-0.4	-0.2	-0.4	-0.3	0.5	1.2	1.1	1.8


Burimi: BPRMV-ja.

	Depozita të ndërmarrjeve				2022				2023	
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2
ndryshime tremujore, në %										
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	-0.9	5.6	0.8	5.8	-7.8	-3.2	6.3	9.3	-5.8	9.4
kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të depozitave, në p.p.										
Para të depozituara	-0.3	3.1	-0.4	5.1	-6.0	-0.4	4.7	3.2	-4.5	5.5
Depozita në denarë	-0.3	-0.4	-0.8	-1.4	-0.4	-0.2	1.1	0.5	0.6	1.4
Depozita në valuta të huaja	-0.3	2.9	2.1	2.1	-1.4	-2.6	0.4	5.7	-1.9	2.5
Depozita afatshkurtër	-0.7	1.3	1.6	1.7	-0.6	-0.8	0.9	5.4	-1.1	2.2
Depozita afatgjata	0.1	1.2	-0.4	-0.9	-1.1	-2.0	0.7	0.7	-0.2	1.7

Burimi: BPRMV-ja.

⁵⁹ Rritja e depozitave të kompanive në tremujorin e dytë është pjesërisht si pasojë e transfereve nga shteti në ESM-ë për nevojat energjetike.

Analiza e normës së kthimit⁶⁰ e kursimeve të reja tregon se në maj normat e interesit të të sapo pranuar⁶¹. Depozitat në denarë dhe në valutë të **amvisërive** janë 2,5% përkatësisht 1,9% (2,9% përkatësisht 1,7% në mars). Në këto kushte, diferenca e interesit ndërmjet kursimeve të reja në denarë dhe valutë të ekonomitë e amvisërive u zvogëlua në muajin maj dhe arrin në 0,7 p.p. (1,2 p.p. në tremujorin e paraprak). Te **sektori i korporatave**, normat e interesit për depozitat e sapo pranuar në denarë dhe në valutë në muajin maj shënuan 1,9% përkatësisht 0,9% (1,2% përkatësisht 0,9%, në mars). Me këto ndryshime, diferenca e interesit ndërmjet depozitave të reja të pranuar në denarë dhe depozita të ndërmarrjeve në fund të muajit maj u zgjerua dhe arriti në 1,0 p.p. Sa i përket numrit të përgjithshëm të depozitave të pranuar (në denarë dhe valutë), normat e interesit për depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive të amvisërive në muajin maj arritën 1,9%, përkatësisht 1,2%, dhe janë më të larta se në mars 2023 (1,7%, përkatësisht 1,0%).



4.2. Aktiviteti kreditor

Aktiviteti kreditues i bankave në tremujorin e dytë të vitit shënoi rritje të moderuar prej 2,6%, pas stagnimit të tremujorit paraardhës. Arritjet konfirmohen përgjithësisht nga rezultatet e **Anketës mbi aktivitetin kreditor**. Në lidhje me **kushtet për miratimin e kredisë**, Në tremujorin e dytë të vitit 2023, shtrëngimi neto i kushteve të përgjithshme të kredisë së ndërmarrjeve është pothuajse identik me tremujorin e mëparshëm. Nga ana tjetër, intensitet më i ulët i shtrëngimit neto është vërejtur te kredia konsumatore për amvisëri krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndërsa tek kredia për banesa ka pasur lehtësim të lehtë neto të kushteve të kredisë. Në lidhje me **kërkesën**, te ndërmarrjet, është vërejtur rritje e vogël e kërkesës për kredi, në ndryshim nga rënia e shprehur në anketë nga tremujori paraardhës, ndërkohë që në sektorin e amvisërive, bankat në anketë vijnë të tregojnë rënie të ndjeshme neto të kërkesës për kredi. Për tremujorin e tretë të vitit 2023, bankat në sektorin e ndërmarrjeve presin lehtësim neto të kushteve të kreditore, me rritje neto të moderuar të kërkesës për kredi, ndërsa për amvisëritë pritet shtrëngim neto i kushteve të kredisë dhe rritje e moderuar neto e kërkesës për kredi.

⁶⁰ Të dhënat e normave të interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori 2018. Më shumë informacione mund të gjinden në lidhjen në vijim:

http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

⁶¹ Lidhur me normat e interesit të depozitave të sapo pranuar duhet të kemi parasysh se këto janë lëvizje të ndryshueshme karakteristike. Ndryshueshmëria e normave të interesit të depozitave të sapo pranuar vjen nga fakti që ato vijnë nga vëllimi i depozitave të sapo pranuar (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë) dhe nga norma e tyre e interesit.

**Totali kredive në sektorin privat**

	2021				2022				2023	
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2
Ndryshime tremujore, në p.p.										
Totali kredive në sektorin privat	1.2	2.6	1.1	3.1	2.6	2.7	1.1	2.6	0.0	2.6
kontribut në ndryshimin tremujor të kredive totale, në p.p.										
Kredi në denarë	0.7	1.8	0.7	2.4	1.3	1.1	-0.2	1.2	-0.3	1.3
Kredi në valuta të huaja	0.5	0.8	0.4	0.7	1.3	1.6	1.4	1.4	0.4	1.3
Kredi afatshkurtër	0.5	0.6	-0.4	0.8	1.4	0.5	-0.1	0.5	-0.4	0.0
Kredi afatgjatë	0.5	1.9	1.5	2.6	1.3	2.0	1.2	2.5	0.6	2.5
Amvisëri	0.8	1.4	0.9	0.8	0.8	1.3	0.8	0.7	0.6	1.1
Ndërmarrje	0.4	1.1	0.3	2.3	1.8	1.3	0.3	1.9	-0.6	1.5


Burimi: BPRMV-ja

kushte për miratimin e kredive

Burimi: anketë për aktivitet kreditor, BPRMV-ja

Analiza e strukturës së sektorit e kredisë për sektorin privat tregon për rritje të moderuar tremujore të bilancit të kredisë në të dy sektorët, dhe lëvizjet janë të ngjashme nga **aspekti valutor**. Në raport të **strukturës së maturimit**, përshpejton rritjen e kredive afatgjata, me rënie të mëtejshme të kredisë afatshkurtër. Njëkohësisht, pjesëmarrja e **kërkesave të dyshimta dhe kontestuese** në numrin e përgjithshëm të kredive është ende e ulët është ruajtur në nivelin prej 2,8%.

Pjesëmarrje të kërkesave të dyshimta dhe kontestuese në totalin e kredive
(në %)



* I referohet pjesëmarrjes së kërkesave të dyshimta dhe kontestuese në totalin e kredive të sektorit përkatës
Burimi: BPRMV-ja.

Në bazë vjetore, në pajtim me shtrëngimin gradual të politikës monetare, norma e rritjes së totalit të kredive në tremujorin e dytë ngadalësoi edhe më tutje dhe është 6,5% (6,6% në fund të tremujorit të kaluar). Në kushtet e rritjes më të fuqishme të depozitave, pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të kredive në depozitat e përgjithshme është ulur edhe në tremujorin e tretë është 84,0% (85,6% në fund të tremujorit të parë).

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, **kreditimi i sektorit "amvisëritë"** shënoi rritje tremujore të butë prej 2,2% (ritje prej 1,2 % në tremujorin e kaluar), me rritje të moderuar të kredive konsumatore dhe të banimit, dhe në +pjesë të vogël edhe nga kreditë për automobilë. Rezultatet nga **Anketa për aktivitet kreditor** për tremujorin e dytë të këtij viti, tek **sektori i "amvisërive"**, ende tregojnë për




rënie të ndjeshme neto të kërkesës për kredi totale, me shtrëngim neto më të ulët të kushteve të kredisë në krahasim me tremujorin e mëparshëm. **Nga aspekti valutor**, kontribut të rritjes kanë edhe kreditë në denarë dhe kreditë valutore. Shikuar nga aspekti i **strukturës së afatizimit**, rritja rezulton nga kreditë afatgjata, pa ndryshime të kredive afatshkurtra. **Në bazë vjetore**, kreditë totale të amvisërive në fund të tremujorit të dytë të vitit 2023 janë më të larta për 6,4%, (ritje prej 6,8% në tremujorin e kaluar).

Kredi të amvisërive

	2021				2022				2023	
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2
ndryshime tremujore, në %										
Totali kredive të amvisërive	1.6	2.8	1.7	1.6	1.6	2.6	1.5	1.4	1.2	2.2
kontribut në ndryshimin tremujor të totalit të kredive, në p.p.										
Kredi në denarë	1.0	1.3	1.0	0.9	1.0	1.3	0.5	0.1	0.3	0.8
Kredi në valuta të huaja	0.5	1.4	0.6	0.6	0.6	1.3	1.0	1.3	0.8	1.4
Kredi afatshkurtë	0.2	0.1	0.0	-0.2	0.2	0.1	0.0	-0.2	0.2	0.0
Kredi afatgjatë	1.1	2.7	1.6	2.0	1.3	2.4	1.5	1.9	1.0	2.2

Burimi: BPRMV-ja.




Në tremujorin e dytë të vitit 2023, shuma e **kredive totale të miratuara në sektorin e ndërmarrjeve** është rritur për 2,1% (pas rënies prej 1,2% në tremujorin e kaluar). Sipas rezultateve nga **Anketa për aktivitet kreditor** për tremujorin e dytë të vitit 2023, bankat tregojnë ulje neto të moderuar të kërkesës së kredive totale nga ndërmarrjet, me shtrëngim të ngjashëm neto të kushteve të kredisë. Nga **aspekti valutor**, janë rritur edhe kreditë në denarë dhe në valutë (përfshirë kreditë me klauzolë në valutë). Sipas **strukturës së afatizimit**, në këtë tremujor ka rritje më të fortë të kredisë afatgjatë, krahasuar me rritjen e kredisë afatshkurtër. Krahasuar **në nivel vjetor**, rritja e kredive totale të ndërmarrjeve në fund të tremujorit të dytë është 6,5% (6,2% në fund të tremujorit të kaluar).

Kredi të ndërmarrjeve

	2020				2021				2022				2023	
	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1
ndryshime tremujore, në %														
Totali i kredive të ndërmarrjeve	1.0	0.8	2.3	0.6	4.9	3.7	2.8	0.7	3.9	-1.3	3.1			
kontribut në ndryshimin tremujor të totalit të kredive, në p.p.														
Kredi në denarë	0.5	0.2	2.3	0.3	4.1	1.7	0.9	-1.0	2.4	-1.1	2.0			
Kredi në valuta të huaja	0.6	0.6	0.1	0.2	0.8	2.0	1.8	1.8	1.5	-0.2	1.1			
Kredi afatshkurtër	0.9	0.9	1.1	-0.7	1.9	2.7	0.9	-0.3	1.3	-1.4	0.3			
Kredi afatgjatë	0.4	-0.1	1.1	1.5	3.3	1.3	1.5	1.0	3.1	0.2	2.6			

Burimi: BPRMV-ja.

Sipas të dhënave për normat e interesit⁶² të kredive të sapomiratuara⁶³ në maj, normat e interesit të kredive në denarë dhe kredive në valutë të huaj **të amvisërive** janë 5,9% dhe 4,3%, respektivisht (6,1% dhe 4,1%, respektivisht në mars). Në këto kushte, diferenca e interesit ndërmjet kreditimit në denarë dhe në valutë të amvisërive është 1,6 p.p. (2,0 p.p. në tremujorin e mëparshëm). **Tek ndërmarrjet**, normat e interesit të kredive të sapo miratuara në denarë dhe kredive valutore janë 5,2% dhe 5,6%, (5,2% dhe 5,5%, respektivisht në mars), ku diferenca e interesit ndërmjet kreditimit të ri në denarë dhe devizore të ndërmarrjeve është rritur dhe është 0,4 p.p.. Në lidhje me **kreditë totale** të miratuara në sektorin privat, në fund të muajit maj, normat e interesit të kredive të amvisërive dhe kredive të ndërmarrjeve janë 5,3% dhe 4,8%, respektivisht në mars të vitit 2023.



V. Financat publike

Në tremujorin e parë të vitit 2023 është shënuar rritje e lartë vjetore e të ardhurave në buxhet, nga 15,6%, e cila është nxitur kryesisht nga flukset hyrëse nga donacioni nga Bashkimi European për përballimin e krizës energjetike dhe nga të ardhurat nga kontributet e mbledhura. Në të njëjtën kohë, ngadalësim i dukshëm i rritjes vërehet te shpenzimet buxhetore, të cilat arrijnë në 9,1%, me rritje të njëkohshme të shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale. Deficiti buxhetor është 0,4% të PBB-së dhe është pak më i ulët krahasuar me realizimin në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar (0,8% e PBB-së). Në periudhën janar-maj 2023, deficiti buxhetor arrin në 1,7% të PBB-së, që përfaqëson rreth 35% të planit për vitin 2023 dhe financohet plotësisht nëpërmjet huamarrjes shtetërore në tregjet e huaja dhe vendase, duke akumuluar depozitat shtetërore në Bankën Popullore. Borxhi publik total në fund të tremujorit të parë 2023 është 58,3% e PBB-së.

Në tremujorin e parë të vitit 2023, të hyrat totale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁶⁴ shënuan rritje prej 15,6% me bazë vjetore (7,1% në tremujorin e katërt të vitit 2022). Rritja e të ardhurave buxhetore në nivel vjetor është reflektim të rritjes së hyrjeve pothuajse në të gjitha kategoritë e të hyrave buxhetore, kryesisht për shkak të hyrjeve më të larta nga donacionet në kuadër të të hyrave të tjera⁶⁵ dhe nga kontributet (me kontribut pozitiv prej 7,6 p.p. dhe 6,0 p.p., në rritjen e të

⁶² Të dhënat për normat e interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullorenga qershori 2018. Informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjinden në lidhjen në vijim http://www.nbkm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.


⁶³ Lidhur me normat e interesit të kredive të sapo pranuar duhet të kemi parasysh se për ato janë lëvizje karakteristike të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të sapo miratuara vjen nga fakti që ato vijnë nga vëllimi i kredive të sapo miratuara (e cila nga muaji në muaj mund të ndryshohet) dhe nga norma e tyre e interesit.

⁶⁴ Buxheti qendror dhe buxheti i fondeve.


⁶⁵ Të ardhurat e tjera përfshijnë të ardhurat nga kapitali, donacionet e huaja dhe të ardhurat nga huatë e rikuperuara. Flukset hyrëse nga donacionet janë për shkak të grantit të marrë nga Bashkimi European në vlerë prej rreth 72 milionë euro në mars 2023, i dedikuar për përballimin e krizës energjetike.



ardhurave totale). Të hyrat nga tatimet⁶⁶ shënuan rritje vjetore më të moderuar prej 2,5% (kontribut pozitiv prej 1,5 p.p. në rritjen e të ardhurave totale), si dhe rritja e të ardhurave jotatimore ishte gjithashtu më e dobët (me kontribut të vogël pozitiv prej 0,4 p.p.).




Burimi: Ministria e financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.




Burimi: Ministria e financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Rritja e të ardhurave totale tatimore prej 2,5% gjatë tremujorit të tretë 2023 rezulton kryesisht nga të ardhurat më të ulëta nga taksat e tërthorta (me kontribut negativ prej 1,2 p.p.), ndërsa taksat e drejtpërdrejta rriten në mënyrë më të moderuar (me kontribut pozitiv prej 4,4 p.p.). Në taksat e tërthorta, ulja rezulton nga të hyrat më të ulëta të TVSh-së (me kontribut negativ prej 1,9 p.p.), me kontribut më të vogël pozitiv të akcizës dhe detyrimeve të importit.





Burimi: Ministria e Financave



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

⁶⁶ I përfshin edhe llogaritë e të ardhurave personale (LIAP).

Shpenzimet totale buxhetore të realizuara në tremujorin e parë 2022 shënuan rritje të moderuar prej 3,4% me bazë vjetore. Nga pikëpamja strukturore, rritja e shpenzimeve totale rezulton nga shpenzimet më të larta kapitale (kontributi prej 8,4 p.p.), me kontribut të vogël pozitiv në shpenzimet kapitale (nga 0,9 p.p.). Rritja vjetore e shpenzimeve aktuale prej 9,1% rrjedh më së shumti nga kategoria e “transfereve”⁶⁷ (kontribut prej 6,1 p.p., më së shumti lidhet me pagesat e subvencioneve për fermerët dhe rritjen e pensioneve⁶⁸), me kontribut më të vogël pozitiv nga kategoritë “pagesat e interesit”, “rrogat dhe kompensimet” dhe “mallrat dhe shërbimet” (kontribut pozitiv prej 1,7 p.p., 0,7 p.p. dhe 0,6 p.p.).



Deficiti buxhetor në tremujorin e parë të vitit 2023 arriti në 3.515 milionë denarë, ose 0,4% të PBB-së⁶⁹, që paraqet arritje pak më të ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (deficit prej 0,8% të PBB-së). Deficiti i realizuar është financuar kryesisht nëpërmjet huamarrjes së jashtme neto të shtetit⁷⁰ dhe në tregun e brendshëm, duke grumbulluar njëkohësisht depozitat e shtetit.

⁶⁷ Kategoria “transferta” i referohet shpenzimeve të pensioneve, shpenzimeve të sigurimeve shoqërore, shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe transferta të tjera (kryesisht subvencione).

⁶⁸ Në mars 2023, pensionet u rritën nominalisht me 8,4% në pajtim me garmonizimin e rregullt të parashikuar nga metodologjia e re që ndjek dy tregues, pra 50% të rritjes së rrogës mesatare dhe 50% të rritjes së shpenzimeve të jetesës sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror për Statistikë. Ky harmonizim bëhet dy herë në vit, në mars dhe shtator. Gjithashtu, në pajtim me pakon e re të masave të synuara për të ndihmuar grupet më të cenueshme të qytetarëve, të miratuar në tetor të viti 2022, në 4 muajt e ardhshëm (nëntor e dhjetor 2022, si dhe janar e shkurt 2023) janë paguar nga 1.500 denarë për pensionistët që marrin deri në 11.525 denarë pension dhe 750 denarë për pensionistët që marrin nga 11.525 deri në 14.000 denarë pension.

⁶⁹ Si pjesë e analizës, projeksionet e prillit të Bankës Popullore janë përdorur për PBB-në nominale për vitin 2023.

⁷⁰ Në muajin mars u emetua eurobondi i nëntë në vlerën 500 milionë euro, me kupon 6,96% dhe me afat maturimi katërvjeçar.


**BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË MAQEDONISË (Buxheti Qendror dhe Buxheti i Fondeve)**

	2022						2023			2022				2023			
	Buxheti për vitin 2022	Ribalancimi i buxhetit për vitin 2022	Shpërndarja I e buxhetit për vitin 2022	Shpërndarja II e buxhetit për vitin 2022	Tr.4	Gjithsej	Buxheti për 2023	Tr.1	jan. -maj 2023	Tr.4		Gjithsej		Tr.1		janar - maj	
										Ndryshime vjetore, në %	Kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.	Ndryshime vjetore, në %	Kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.	Ndryshime vjetore, në %	Kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.	Ndryshime vjetore, në %	Kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.
TË HYRA TOTALE	238,899	245,758	245,758	245,758	64,500	243,085	282,052	66,040	109,599	7.1	7.1	11.5	11.5	15.6	15.6	14.5	14.5
Të hyrat tatimore dhe kontributet	210,829	221,770	221,770	221,770	58,456	220,186	250,689	56,652	97,100	8.7	7.8	12.2	10.9	8.3	7.6	11.1	10.2
Tatimet*	136,458	143,173	143,173	143,173	36,839	142,567	162,600	35,897	61,523	6.6	3.8	13.4	7.7	2.5	1.5	7.1	4.3
Kontribute	74,371	78,597	78,597	78,597	21,617	77,619	88,089	20,755	35,577	12.7	4.0	9.9	3.2	20.0	6.0	18.9	5.9
Të hyra jotatimore	19,171	17,043	17,043	17,043	4,548	17,189	19,894	3,935	6,472	21.4	1.3	23.8	1.5	6.9	0.4	-2.2	-0.2
Të hyra kapitale	3,330	2,180	2,180	2,180	514	2,273	2,800	193	332	90.4	0.4	17.9	0.2	-31.3	-0.2	-31.7	-0.2
Donacione nga jasht	5,570	4,765	4,765	4,765	982	3,437	8,669	5,260	5,695	-60.3	-2.5	-41.7	-1.1	533.7	7.8	348.4	4.6
SHPENZIME TOTALE	272,428	288,493	288,493	288,493	83,927	278,596	324,810	69,555	124,620	14.9	14.9	8.4	8.4	9.1	9.1	19.6	19.6
Shpenzime rrjedhëse	234,192	256,384	255,808	255,906	68,013	249,959	276,059	64,231	108,296	5.5	4.8	7.0	6.4	9.1	8.4	11.7	10.9
Shpenzime kapitale	38,236	32,109	32,685	32,587	15,914	28,637	48,751	5,324	16,324	85.3	10.0	22.3	2.0	8.3	0.6	124.9	8.7
DEFICITI / SUFICITI BUXHETOR	-33,529	-42,736	-42,736	-42,736	-19,427	-35,511	-42,759	-3,515	-15,021								
Financim	33,529	42,736	42,736	42,736	19,427	35,511	42,759	3,515	15,021								
Të hyrat	45,103	54,513	54,513	54,513	25,084	46,869	94,876	9,550	22,277								
Të hyra të tjera	500	500	500	500	320	906	0	287	564								
Kredi të huaja	21,269	65,524	65,524	65,524	23,276	24,895	66,876	31,142	31,305								
Depozita	-3,296	-38,141	-38,141	-38,141	-1,566	6,387	-5,626	-35,066	-24,852								
Bonot shtetërore	26,620	26,620	26,620	26,620	3,054	14,681	33,616	13,187	15,260								
Shitja e aksioneve	10	10	10	10	0	0	10	0	0								
Të dalat	11,574	11,777	11,777	11,777	5,657	11,358	52,117	6,035	7,256								
Shlyerja e kryegjyjes	11,574	11,777	11,777	11,777	5,657	11,358	52,117	6,035	7,256								
Borxhi i jashtëm	6,045	6,235	6,235	6,235	1,896	5,787	36,506	1,055	2,276								
Borxhi i brendshëm	5,529	5,542	5,542	5,542	3,761	5,571	15,611	4,980	4,980								
Shpenzime tjera																	

* Përfshin të hyra tatimore (SSP).

Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Në periudhën janar - maj 2023, të hyrat totale buxhetore janë më të larta me 14,5% me bazë vjetore. Pjesa më e madhe e rritjes, ose 5,9 p.p., vjen nga arritjet më të mira tek kontributet, ndërsa donacionet e huaja dhe të ardhurat tatimore dhe kanë kontribut pozitiv pak më të vogël (nga 4,6 p.p dhe 4,3 p.p., respektivisht), ndërsa të ardhurat kapitale dhe të ardhurat jotatimore kanë kontribut negativ (nga 0,2 p.p., respektivisht). Njëkohësisht, shpenzimet buxhetore janë më të larta për 19,6% në bazë vjetore. Analizuar sipas kategorive, rritja e shpenzimeve buxhetore në pjesën më të madhe vjen nga shpenzimet aktuale më të larta⁷¹, me kontribut prej 10,9 p.p dhe shpenzimeve kapitale⁷² me kontribut pozitiv prej 8,7 p.p. Në pesë muajt e parë të vitit 2023, deficiti buxhetor arrin në 15.021 milionë denarë ose 1,7% të BPV-së, që paraqet 35,1% të deficitit të planifikuar për vitin 2023. Financimi i deficitit buxhetor në këtë periudhë më së shumti është realizuar përmes huamarrjes së shtetit në tregun e jashtëm dhe të brendshëm, në kushtet e akumulimit të depozitave të shtetit në Bankën Popullore.

Borxhi publik
në % të PBB-së

Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së

⁷¹ Rritja vjen më së shumti nga zëri i transfereve, i cili është rritur për shkak të transfereve në sektorin energjetik për përballimin e krizës energjetike, pagesës së subvencioneve për fermerët dhe rritjes së pensione.

⁷² Rritja e shpenzimeve kapitale është si rezultat i transferimit të mjeteve financiare në vlerë prej 7.254 milionë denarë, afër fundit të muajit prill, drejtuar Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, për fillimin e ndërtimit dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore për korridorin 8 dhe korridorin 8g.



Borxhi publik total⁷³ në fund të tremujorit të parë të vitit 2022 është 58,3% të PBB-së (59,7% të PBB-së, krahasuar me fundin e tremujorit të kaluar që paraqet rënie prej 1,4 p.p. të PBB-së. Në të njëjtën kohë, borxhi publik i jashtëm dhe i brendshëm është 38,8% dhe 19,5% të PBB-së, që paraqet rënie prej 0,4 p.p. dhe 1,0 p.p. të PBB-së, përkatësisht. Nga këndvështrimi i strukturës së borxhit, borxhi total shtetëror⁷⁴ dhe borxhi i ndërmarrjeve publike (i garantuar dhe jo i garantuar)⁷⁵ janë 50,8% dhe 7,6% të PBB-së, që paraqet ulje prej 0,3 p.p. dhe 1,1 p.p. të PBB-së. Lidhur me periudhën e njëjtë të 2022, borxhi publik total në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023 është më i lartë për 2,7 p.p. të PBB-së.

⁷³ Borxhi publik përkufizohet me Ligjin e Borxhit Publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19) sipas të cilit ai paraqet shumën e borxhit të shtetit dhe borxhi i ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose mbizotruese të shtetit ose të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

⁷⁴ Borxhi shtetëror përkufizohet si shumë e borxheve të qeverisë qendrore, fondet publike dhe komunat.

⁷⁵ Në pajtim me ndryshimet në Ligjin e Borxhit Publik në maj të vitit 2019, borxhi i pagarrantuar i ndërmarrjeve publike dhe shoqëritë aksionare të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit llogaritet në borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19).